



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Shkenca Politike”, me profile “Administrim Publik”,
“Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, i Institucionit të Arsimit
të Lartë
“Universiteti European i Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Elda Zotaj

2. PhD. Gert Guri

Mars / 2024

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile
“Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Europian i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM nr. 74, datë 21.01.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati nr. 7, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën nr. 8244/1 prot., datë 04.09.2018 (deri në 20%)
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 81, datë 03.02.2021 Urdhër nr. 84, datë 03.02.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 68, dt. 14.02.2011; VBA Nr. 27, dt. 13.07.2018, ndryshuar me VBA Nr. 27/1 dt. 07.12.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18-19: 9 PAE / 1 PAK 19-20: 8 PAE / 2 PAK 20-21: 9 PAE / 2 PAK 21-22: 8 PAE / 1 PAK 22-23: 11 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	18-19: 5 studentë 19-20: 17 studentë 20-21: 20 studentë 21-22: 23 studentë 22-23: 9 studentë




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile, ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës, është licensuar si program studimi i ciklit të dytë në studimet universitare me VKM nr. 74, datë 21.01.2009, me emërtimin “Shkenca Politike”, që mund të ofrohet në profilet: “Politikë e krahasuar” ose “Teori politike”. Programi i studimit është akredituar me Urdhër Nr. 68, dt. 14.02.2011 dhe VBA Nr. 27, dt. 13.07.2018, ndryshuar me VBA Nr. 27/I dt. 07.12.2018.

Programi synon të ofrojë një kurrkulum që harmonizon njohuritë teorike me nevojat në rritje që kanë institucionet shqiptare edhe në procesin e integritimit evropian për specialistë me këto njohuri. Për këtë qëllim programi të gërshetojë komponentin teorik me praktikatat mësimore pranë institucioneve partnere të institucionit.

Me Vendim Senati Nr. 07 Prot., datë 14.06.2018 është miratuar nga UET riorganizimi dhe përshtatja e programit të studimit nga Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profilet: a. Teoritë politike; b. Politikë e krahasuar, në Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profilet: a. Strategji politike; b. Gjeopolitikë; c. Marrëdhënië Publike Politike; d. Administrim Publik; e. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh, konfirmuar me shkresën e MASR Nr. 8244/1 Prot., datë 04.09.2018, si ndryshime në masën deri në 20%.

Ky proces akreditimi ka për objekt vlerësimi vetëm profilet aktive të programit “Administrim Publik” dhe “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile “Administrim Publik” dhe “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi ofrohet me kohëzgjatjen 2 vite akademike, me 120 kredite, në gjuhën shqipe. Një pjesë e lëndëve ofrohen edhe në gjuhë të huaj me qëllim përthithjen e sa më shumë studentëve të huaj por edhe integrimin sa më të mirë të studentëve shqiptare në programet e evropiane të edukimit sic janë Erasmus.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.


Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga Dr. Elda Zotaj ekspert vendas dhe PhD. Gert Guri ekspert i huaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Ersi Dako, Koordinatore Teknike e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **3 dhe 4 Tetor 2023** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u përcoll në Institucion përmes AMS më datë 31.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 40/2 Prot., datë 31.01.2024.

Institucioni përcolli komentet përmes AMS më datë 06.03.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 37/1 Prot., datë 07.03.2024.



GVJ, pasi shqyrtoi me kujdes komentet e IAL-së, evidenton si më poshtë vijon:

1. Standardi IV, kriteri 1

Komenti i IAL-së: Duke qënë se konstatimet e mësipërme, nuk na u bënë me dije gjatë takimeve në institucion, përfitojmë nga rasti të bëjmë shpjegimet përkatëse:

- Nga verifikimet e kryera u konfirmua pasaktësia e GVB në plotësimin e tabelave 6.1 dhe 12.1 për vitin akademik 2018-2019. Prof. Asoc. Dr. S.Xh dhe Msc. M.A janë angazhuar në zhvillimin e lëndës “Teori dhe Modele Zhvillimi” dhe gabimisht njëri është raportuar tek tabela 6.1 dhe tjetri tek 12.1, ndërkohë që duhet të ishin raportuar së bashku.

- Për sa i përket pedagogut K.L Dr/proces, ai është angazhuar në zhvillimin e seancave të këshillimit të karrierës, 10 orë njësi, të cilat zhvillohen në kuadër të praktikës profesionale, për të këshilluar studentët në lidhje me si të zhvillojnë një aplikim të suksesshëm për punë, si të paraqiten në intervistë, etj. Më pas studentët vijnë me praktikën në institucionet/organizatat/kompanitë përkatëse. Ndonëse këto orë llogariten në ngarkesën mësimore të pedagogut që i zhvillon, nuk konsiderohet si mësimdhënie në kuptimin klasik të fjalës, ndaj edhe pedagogu nuk është përfshirë në tabelat e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit (bashkëngjitur komentit të dhënë për ngarkesën e K.L).

Përgjigja e GVJ-së: GVJ, duke patur parasysh saktësimin e paraqitur nga institucioni, merr në konsideratë komentin e bërë dhe pasqyron ndryshimin në këtë standard, duke hequr paragrafin e cituar më herët.

2. Standardi IV. 3, kriteri 3

Komenti i IAL-së: Në lidhje me këtë konstatim, sikurse u konfirmua dhe gjatë vizitës së ekspertëve, silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit akademik dhe na lejoni më poshtë të rendisim masat e marra përgjatë çdo viti akademik në adresimin e këtij aspekti të cilësisë në programin e studimit: - Lënda “E drejtë kushtetuese e krahasuar” nga ky vit akademik nuk është më pjesë e kurrikulës së programit (ju lutem referohuni dokumentit të kërkuar në vizitë: 2.1. Vendim Dekanati_Vendim Departamentit_per miratimin e ndryshimeve ne kurrikula). Në DVV është përfshirë silabusi i v.a.2021-2022, ndërsa për vitin akademik 2022-2023, Departamenti ka kryer rishikimin e literaturës, dhe lënda ka qënë aktive vetëm gjatë v.a. 2022-2023, për studentët që u është dashur të mbyllin studimet me kurrikulën sipas parashikimeve ligjore (bashkëlidhur silabusi: Sillabus E drejte Kushtetuese e Krahasuar 2022-2023). - Lënda “Institucionet politike” gjithashtu nuk është më pjesë e kurrikulës së programit (ju lutem referohuni dokumentit të kërkuar në vizitë: 2.1. Vendim Dekanati_Vendim Departamentit_per miratimin e ndryshimeve ne kurrikula). – Lënda “Komunikim masiv bashkëkohor”, në DVV është përfshirë silabusi i v.a.2021-2022, ndërsa për vitin akademik 2022-2023, Departamenti ka kryer rishikimin e literaturës, dhe lënda ka patur literaturë të përditësuar (bashkëlidhur silabusi: Komunikim masiv bashkëkohor 2022-2023).

Përgjigja e GVJ-së: GVJ, duke patur parasysh sqarimin dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga institucioni, merr në konsideratë komentin e bërë dhe pasqyron ndryshimin përkatës në kriterin e këtij standardi dhe tek konkluzionet, standardin II.4, kriteri 5 dhe konkluzionet, si dhe vlerësimin për shkallën e përmbushjes së këtyre standardeve.

3. Standardi I.3, kriteri 3 dhe Standardi II.1, kriteri 3

Komenti i IAL-së: Për sa i përket formulimeve në Standardin I.3, Kriteri 3; Standardi II.1, Kriteri 3 dhe Konkluzione, lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale, kjo temë u diskutua gjatë dhe në që GVJ zhvilloi në UET. Sikurse jua bëmë me dije dhe ekipit të vlerësimit të jashtëm, rishikimi i kurrikulës është bërë konform akteve nënligjore në fuqi, e konfirmuar kjo dhe me shkresë të MAS nr. 2484/1 prot., dt.21.08.2023. Në këtë kuptim, nuk ka asnjë pengesë ligjore që praktika profesionale të zhvillohet që në vitin e parë të studimeve, për më tepër, duke qënë se studentët e programit “Master i Shkencave” në “Shkenca Politike”, kanë kryer studimet e mëparshme Bachelor dhe nuk u mungojnë njohuritë dhe aftësitë bazë për t’i aplikuar ato në vendin e punës ku kryejnë praktikën profesionale, pasi diploma Bachelor i siguron të diplomuarve akses në tregun e punës. Zhvendosja e këtij detyrimi nga viti i dytë i studimeve në vitin e parë është bërë për të ndihmuar integrimin e tyre më të shpejtë në tregun e punës dhe rritur mundësitë për punësim që gjatë studimeve të ciklit të dytë të studimeve.

Sigurisht ekspertët janë në të drejtën e tyre të sugjerojnë ndryshimet që i konsiderojnë të arsyeshme, megjithatë dëshirojmë të nënvizojmë se në këtë rast kemi të bëjmë me aspekte që i takon institucionit të bëjë zgjedhjet e veta në kuadër të lirisë akademike që gëzon në përputhje me Nenin 3, pika 2, e Ligjit Nr. 80/2015 pasi nuk ka asnjë akt nënligjor që të përcaktojë se në cilën periudhë kohore të programit duhet të kryhet praktika profesionale. Për rrjedhojë, kërkohet që edhe nëse rekomandimi do të qendrojë në përmbajtjen e RVJ, të mos përfshihet në rekomandimet e detyrueshme për t’u zbatuar nga insitucioni.

Përgjigja e GVJ-së: GVJ, duke patur në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi, dëshiron të saktësojë se nuk e konsideron zhvendosjen e praktikës nga viti i parë në vitin e dytë si një rekomandim të detyrueshëm, megjithatë, GVJ këshillon që, në mbështetje dhe të eksperiencave ndërkombëtare, të shikohet mundësia që praktika mësimore të realizohet në vitin e dytë. Për sa më lart, ky rekomandim do të vijojë të qëndrojë në raport, por duke shtuar këtë saktësim të bërë si më lart nga ana e GVJ-së në standardin II.1, kriteri 3 dhe duke hequr fjalinë e fundit të konkluzioneve tek ky standard.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në VBA Nr. 27, dt. 13.07.2018, ndryshuar me VBA Nr. 27/1 dt. 07.12.2018, janë:

1. IAL të shikojë mundësinë e rishikimit të planit mësimor të këtij programi vecanërisht në lëndët që synojnë profilizimin e studentëve në dy profilet kryesore të programit duke rritur peshën e lëndëve/moduleve profilizuese.
2. IAL të krijojë mundësi shtesë për stafin akademik dhe studentët e këtij programi studimi, për të krijuar një përfshirje më të lartë dhe më cilësore të tyre në veprimtarinë kërkimore-shkencore të institucionit.
3. IAL të krijojë mundësi alternative dhe shtesë për rritjen e shkallës së mobilitetit të studentëve në universitete dhe institucione të huaja partnere.
4. IAL të mundësojë lidhjen e marrëveshjeve specifike të bashkëpunimit me institucione publike apo private në kuadër të realizimit të praktikës profesionale të këtij programi studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni:

Për rekomandimin e parë GVJ vlerëson se është *përbushur* falë ndryshimit të cilit i është nënshtruar programi për të përbushur këto rekomandime. Në akreditimin e mëparshëm programi kishte vetëm dy profile: profilin “Politikë e Krahasuar” dhe profilin “Teori Politike”. Duke patur parasysh specializimin që kërkon tregu i punës nga studentët që mbarojnë këtë degë studimesh janë shtuar edhe profile që ofrojnë njohuri specifike siç janë Menaxhim Vlerësim Projektsh dhe Administratë Publike. Këto profilizime përbëjnë rreth 15% të programit me vlerën e 18 ECTS. Për më tej studentët kanë mundësi që të kryejnë edhe temën e diplomës në këto profile të programit të studimit.

Për rekomandimin e dytë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Studentët dhe pedagogët kanë mundësinë që të publikojnë në Revisitën Jus Justicia duke përfshirë edhe temat e diplomës duke u bazuar në rekomandimet e udhëheqësit të tezës, për të garantuar cilësinë e materialeve të botuara (<https://uet.edu.al/jus-justicia/full-issues/>). Studentët kanë mundësinë që të prezantojnë punimet e tyre shkencore edhe në “Ditët e Studimeve Shqiptare për Kërkuesit e Rinj”, një aktivitet që organizohet në mënyrë periodike duke filluar nga viti 2019 (<https://uet.edu.al/en/konferenca/>). Përveç botimit në revistën Jus-Justicia pedagogët kanë mundësinë që të prezantojnë punimet e tyre në “Ditët e Studimeve Shqiptare”, një aktivitet që organizohet çdo vit duke filluar nga viti 2014 (<https://uet.edu.al/en/konferenca/>). Këto punime botohen edhe në Proceedings të këtij aktiviteti, ndërsa pjesëmarrja me punime në këtë revistë është pa pagesë për të promovuar pjesëmarrjen e pedagogëve dhe studentëve në këto botime.

Për rekomandimin e tretë GVJ vlerëson se është *përbushur*. Mobiliteti në krahasim me periudhën e akreditimit të mëparshëm është rritur siç tregohet edhe në tabelën përkatëse falë

marrëveshjeve për mobilitetin e studentëve që janë nënshkruar me Universitetin e Salzburgut, Universitetin e Hagës dhe Universitetin e Saxon.

Për rekomandimin e katërt GVJ vlerëson se është *përbushur*. Rritja e numrit të marrëveshjeve të IAL-së me institucionet më profilizuese siç janë një pjesë e institucioneve të administratës publike që merren me menaxhimin dhe zbatimin e projekteve ka ofruar mundësinë që studentët të kenë mundësinë e zhvillimit të këtyre praktikave sa më pranë profilit të tyre. Të dhënat e ofruara nga IAL lidhur me punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve në profile që përputhen me degën e studimit është një tjetër tregues i praktikave mësimore më të profilizuara.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Marrëdhënie Ndërkombëtare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master i “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” i ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara në Universitetin Europian të Tiranës është në harmoni të plotë me interesat dhe objektivat strategjike kombëtare. Institucioni ka një sërë dokumentash nga niveli i programit të studimit si “Planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit” e deri tek Strategjia e Kerkimit Shkencor UET (2021-2025) që dëshmojnë synimin, ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Më konkretisht në vizionin e paraqitur në Strategjinë e Kerkimit Shkencor UET (2021-2025) thuhet se: “UET synon shndërrimin në një qendër ekspertize në fushën e studimeve shoqërore, humane, juridike, ekonomike dhe të teknologjisë së informacionit. Synimi i mëtejshëm është kthimi i UET në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal” (<i>Evidenca Nr. 3.1, Strategjia e Kerkimit Shkencor UET 2021-2025, fq.1</i>). Ky vizion kontribuon me arritjen e interesave kombëtare për të kontribuar në ngritjen e kapitalit human në vend në kuadër të këtij programi përmes përgatitjes së specialistëve dhe ekspertëve në fushën e shkencave politike si aset për administratën publike dhe më gjerë. Në Planin strategjik për zhvillimin e programit të studimit theksohet se “nga elementët kryesor që përbëjnë vizionin e departamenti për këtë program është që ai të kthehet në një qendër të rëndësishme dhe të kontribuojë në jetën publike nëpërmjet studimeve të ndryshmeve, analizave dhe sondazheve që ndihmojnë hartimin e politikave publike dhe masin shqetësimet kryesore të shoqërisë shqiptare” (<i>Evidenca Nr. 4, Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca Politike, fq.3</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Ky program është në përputhje me misionin e fushën e veprimtarisë së UET për të qënë “qendër ekselence në formimin akademik të studentëve..., qendër ekspertize e specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike..., qendër ekselence për kërkimin shkencor”. (<i>Evidenca Nr. 2, Statuti</i>) Qëllimet dhe objektivat e programit Master i “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” shprehen qartë për formimin akademik të</p>




	<p>studentëve bazuar në njohuritë bashkëkohore dhe praktikat e mira në fushë, por edhe në përputhje me kontekstin e zhvillimit të vendit dhe më gjërë. Më konkretisht në dokumentin e titulluar “Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit” thuhet se: “Programi i studimit MSH në Shkenca Politike, synon: 1. të pajisë me formim akademik, shkencor dhe bashkëkohor studentët, mbështetur në prioritetet strategjike përkatëse, që lidhen me rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies, lidhur me lëndët specifike të fushës së Shkencave Politike, duke realizuar formimin e një studenti cilësor dhe të përgatitur në fushën e shkencave politike, menaxhimit dhe vlerësimit të projekteve, administratës publike, medias dhe oraganizatave kombetare dhe ndërkombëtare (në përputhje me profilet që ofron ky program studimi.” (Evidenca Nr. 4, Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca Politike, fq.3). Institucioni ofron programe studimi të afërta me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vizita në institucion dhe takimet me stafin dhe drejtuesit e tij, rezulton se programi është hartuar në përputhje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së përgjithshëm të UET. (Evidenca Nr. 2. Statuti; Evidenca Nr. 5. Rregullore e UET; Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025). Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara pjesë e Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare (Evidenca Nr. 1. Mendimi i Dekanit_MSH SHP; Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit_MSH Shkenca Politike). Emërtimi, struktura dhe organizimi i programit të studimit bazohet dhe është ndërtuar mbi fushat e drejtimit akademik dhe të kërkim zhvillimit të UET. Në hartimin e programit të ciklit të dytë të studimit MSH “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, synohet të formohen studentët me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës në lëmin e Shkencave Politike dhe profilizimeve respektive.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit MSH në Shkenca Politike me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” është hartuar e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit me qasje të bazuar në përputhje me interesin kombëtar si dhe dhe prirjet globale të zhvillimit politik dhe ekonomik. Kurrikula e këtij programi studimi është hartuar duke u bazuar në dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombetare dhe i shërben formimit të profesionisteve në të gjitha nivelet (Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike). Programi synon</p>
	<p>të furnizojë tregun me specialist njohës të politikës, administrimit, zhvillimeve ndërkombëtare duke i shërbyer rritjes së performancës së institucioneve të shtetit dhe organizmave ndërkombëtare që zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë si dhe zhvillimit ekonomik dhe social në</p>

	tërësi.			
Konkluzione	<i>UET, i cili ofron programin e studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", përmbushur kriteret e vlerësimit dhe synon ruajtjen e interesave kombëtare, akteve ligjore dhe nënligjore, etj. Në dokumentat ligjor institucional, janë të shprehura qartë misioni dhe vizioni i institucionit për programe studimi aplikative dhe zhvillimore.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare ku përfshihet edhe programi i studimit është një nga njësitë kryesore të hapura që në themelimin e UET. (Evidenca Nr. 54.1. VKM Nr. 636, datë 20.09.2006 "Për hapjen e UET"). Struktura institucionale e UET-së është në funksion të misionit dhe e organizuar në përputhje me fushën akademike specifike për ofrimin e programit MSH "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" dhe disponon burimet e nevojshme njerëzore, të cilët janë të përfshirë në mësimdhënien e këtij programi. Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni rezultoi se për vitin akademik 2022-2023, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara në përbërje të tij ka 10 anëtarë të stafit akademik efektiv, me kualifikimin 4 Prof.Dr., 2 Prof. As., 2 Dr/PhD dhe 2 me Msc. dhe 2 anëtarë me kontratë, me kualifikimin 1 Prof.Dr., dhe 1 Dr. (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB_MSH_SHP). Departamenti është i përbërë nga anëtarë me përvojë të gjatë akademike dhe profesionale (Evidenca Nr. 20 CV e stafit të cilat janë individuale por të identifikuar me të njëjtin nr evidence).
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, konstatohet se programi MSH në "Shkenca Politike", me profile, që i takon fushës së shkencave humane, është ingranuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Në tërësinë e tij, programi i studimit Master Shkencor "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh", i ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara është në kohezion të plotë me fushën akademike të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Ky program studimi është në nivelin 7 në kornizën kombëtare të kualifikimeve. (Evidenca Nr. 7. Rregullore e

	<i>Programit_MSH_Shkenca_Politike).</i>			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh” ofrohet bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor dhe aktet rregullatore të UET. Programi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara. Bazuar në udhëzimet kombëtare dhe evropiane, ky program ka 120 ECTS, përgjatë dy viteve akademike dhe është i shtrirë në katër semestere. (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike). Nga shqyrtimi që GVB u ka bërë syllabuseve të programit, rezultojnë përputhshmëri e tij me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë. (Evidenca Nr. 19. Syllabus)			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm. Në RVB pohohet se “programi i ciklit të dytë ‘Master’ është brenda profilit të institucionit. (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike, fq. 11)			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Ky kriter nuk është i aplikueshëm. Ajo që pohohet nga institucioni është fakti që “ju krijon mundësinë studentëve aktual dhe atyre të diplomuar (ish-studentëve, pjesë e UET Alumni) që të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me nevojat e tyre për karrierë dhe riorientim në tregun e punës”. (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike, fq. 11)			
Konkluzione	GVJ, bazuar në analizën e standardit I.2, eidenton se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në dokumentet themelore të UET si Statut dhe Rregullore (të bazuara në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tjera nënligjore), janë të përcaktuara qartë strukturat institucionale me karakter akademik dhe administrativ për realizimin e aktiviteteve në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Organizimi i institucionit harmonizon strukturat akademike me ato vendimmarrëse dhe administrative. Strukturat akademike janë të ndërlidhura dhe propozojnë pranë strukturave menaxheriale ndryshimet e nevojshme. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësisë menaxheriale dhe horizontale të institucionit, por peshat

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<p>kryesore mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit (<i>Evidenca Nr. 6 Dokumenti F.IV- F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit</i>). Departamenti ka hartuar dhe një rregullore për këtë program studimi (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike</i>). Institucioni garanton që programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile, të realizohet nga staf i kualifikuar si në drejtimin akademik dhe në atë administrativ apo institucional. Departamenti merr masat që personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) të realizojnë orët mësimore sipas planit mësimor akademik, personeli ndihmës administrativ të jetë në shërbim të vazhdueshëm duke krijuar kushte shumë të mira me qëllim realizimin e programit mësimor dhe të gjitha detyrimeve që rrjedhin prej tij. Gjithashtu, njësi të tjera si: sekretaria, arkiva, shërbimi i informacionit në zyrat e ndryshme, janë në shërbim me kohë të plotë në mënyrë funksionale në realizimin e objektivave të këtij programi studimi. Çdo strukturë/njësi përgjegjëse ndjek dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë e programit të studimit dhe informon drejtuesit përkatës.</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Në dokumentin e titulluar “Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit” thuhet se: “UET ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, duke përfshirë edhe programet e studimit Bachelor Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara përfiton nga marrëveshjet e bashkëpunimit të realizuara në nivel fakulteti ashtu edhe në kuadër të marrëveshjeve të realizuara në nivel institucional. Në nivel përgjithësues përfitimet nga këto marrëveshje janë në disa drejtime kryesore:</p> <p>Së pari, gjenerojë mundësi bashkëpunimi institucional dhe shkëmbim eksperiencash, institucionet publike dhe private përfitojnë dhe ekspertiza akademike dhe profesionalizmi i personelit akademik, ndërsa UET përfiton ekspertizën që ofron tregu i punës;</p> <p>Së dyti, marrëveshjet e bashkëpunimit, krijojnë mundësi që studentët tanë të zhvillojnë praktikat profesionale pranë këtyre institucioneve, duke marrë prej tyre qasjen konkrete të kërkuar nga tregu i punës;</p> <p>Së treti, marrëveshjet shërbejnë për të përmisuar kurrikulat mësimore të programeve të studime nënë konsultimin me aktorët e tregut të punës.</p> <p>Së katërti, japin mundësinë e shkëmbimit të stafëve akademike për shkëmbim eksperiencash me universitetet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke ritur cilësinë e programit dhe stafit akademik me pervojat europiane.” (<i>Evidenca Nr. 35 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>). UET ka 95 marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi me IAL në Europë, Amerikë, Australi dhe Kinë dhe, njëkohësisht, gëzon marrëveshje bashkëpunimi me 15 IAL shqiptare publike dhe jo publike (<i>Evidenca Nr. 34 Marrëveshje bashkëpunimi-lista UET tabela 2 dhe 3; Evidenca Nr. 35 Raporti i</i></p>




	<i>përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit).</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Nga biseda me stafin dhe studentë të programit si dhe shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se për realizimin e programit MSH në “Shkenca Politike”, me profile, për komponentin e praktikës profesionale, institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme me institucione përkatëse të fushës (<i>Evidenca Nr. 35 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>). Duhet theksuar fakti që praktika profesionale realizohet përgjatë gjithë vitit të parë të studimeve, gjë e cila mund të konsiderohet risi, por në gjykimin e ekspertëve lidhja më e mirë dhe përfitimet më të mëdha do të ishin të realizohej në semestrin e dytë të vitit të dytë akademik. Kjo çështje do të shqyrtohet me mirë në seksionet në vijim të raportit (<i>Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike</i>).
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Departamenti harton raport analitik periodik për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programeve të studimit që ai drejton. Dokumenti i titulluar “<i>Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>” ka marrë në analizë marrëveshjet e 4 viteve të fundit. Krahas aspekteve të tjera raporti thekson se “Një nga synimet e UET dhe në veçanti Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, është që marrëveshjet e bashkëpunimit t’i vendosë në funksion të kërkimit shkencor, realizimit të projekteve të përbashkëta dhe aktiviteteve të tjera, përfshirë programet e shkëmbimit (Erasmus: përfshirja në projekte të përbashkëta kërkimore – studimore me institucione analoge europiane në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” (<i>Evidenca Nr.35 Raporti i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit</i>).</p> <p>Gjithashtu, departamenti ka realizuar një analizë me 8 komponentë për arritjen e objektivave formuese MSH “SHkenca Politike”. Më konkretisht analiza konsiston në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Licensimi, akreditimi dhe regjistrimet në programin Master i Shkencave “Shkenca Politike”; 2. Objektivat formuese dhe rezultatet e pritshme të të nxënit; 3. Struktura e programit të studimit; 4. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit; 5. Kalueshmëria e studentëve në lëndët e ofruara në programin MSH “Shkenca Politike”; 6. Aftësitë profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës; 7. Mbi praktikën profesionale; 8. Aktivitetet e Departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara në kuadër të tërheqjes së studentëve. <p>(<i>Evidenca Nr. 38, Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP</i>).</p>
Konkluzione	<i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimin në institucion, GVJ konkludon se njësitë përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin</i>




	<i>e programit sigurojnë marrëdhënie bashkëpunimi me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtare për realizimin sa më efektiv të këtij programi. Njësia bazë realizon raporte analitike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile, është i organizuar sipas sistemit Evropian të Transferimit të Kreditit (ECTS) në total 120 ECTS. Programi ofrohet në kurse të ndara në dy vite akademike bazuar në plotësimin e nevojave të studentëve që ndjekin këtë program dhe natyrës së lëndëve. Gjatë vitit të parë akademik studentit realizon 8 lëndë plus praktikën e cila shtrihet përgjatë gjithë vitit. Në semestrin e I-rë, studentit realizon 3 lëndë dhe praktikën ndërsa në semestrin e dytë 4 lëndë (nga të cilat një është me zgjedhje) plus praktikën. Disa nga lëndët janë: Metoda kërkimi në shkencat sociale; Sistemet e krahasuara të qeverisjes; Teoritë politike bashkëkohore; Etika, komunikimi lidhësi në organizatë; Ekonomi politike ndërkombëtare., etj Gjatë vitit të dytë akademik studentit realizon 3 lëndë në semestrin e parë (nga të cilat një është me zgjedhje) sikundër dhe në semestrin e dytë plus punimin e diplomës që shtrihet përgjatë gjithë vitit. (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike). Programi është në përputhje me kriteret e përcaktuar në VKM Nr. 41/2018 (i ndryshuar). Lëndët e këtij programi janë kategorizuar në kategoritë A-E, dhe kreditet janë në përputhje me përqindjen e parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

	<p>Kategoria A: Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (12 ECTS ose 10%);</p> <p>Kategoria B: Lëndë karakterizuese - përgatitje për disiplinën shkencore (60 ECTS ose 50%);</p> <p>Kategoria C: Lëndë ndërdisiplinore/integruese - grupe disiplinash, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (18 ECTS ose 15%);</p> <p>Kategoria D: Lëndë plotësuese - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (12 ECTS ose 10%);</p> <p>Kategoria E: Detyrime përmbyllëse - punimi i diplomës (18 ECTS ose 15%) (<i>Evidenca Nr.7. Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile, përbën një përpjekje për të aftësuar studentët me dije, njohuri dhe ekspertizë të konsiderueshme profesionale e aplikative. Programi synon përgatitjen e specialistëve të nivelit universitar në shkencat politike, që të jenë të aftë të njohin shkencat politike në tërësi për tu punësuar në sektorin e shoqërisë civile, në media, në organizmat politike, në institucionet politike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, specialistë në administratën publike në të gjithë sektorët e saj (<i>Evidenca Nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP</i>). Programi i studimit synon, nëpërmjet secilës lëndë si dhe profilizimet e ofruara, t’u japë studentëve terminologjinë e duhur që i duhet në formimin e tyre profesional që kombinon teorinë dhe praktikën e shkencave politike si në aspektin teorik dhe atë praktik (<i>Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike</i>). Në syllabuset e lëndëve shprehen qartë dhe në mënyrë eksplicite rezultatet e të nxënësve dhe konceptet kryesore që përfitojnë studentët në fund të çdo lënde (<i>Evidenca Nr. 19, Syllabuset e Lëndëve të ofruara për Programin MSH në Shkenca Politike</i>). Aftësitë shprehimore teknike i lejojnë studentët për t’u përballur me specializime profesionale në punë të kualifikuara ku nevojiten njohuritë që lidhen me këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Shkenca Politike”, me profile, ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Konkretisht, praktika mësimore është e shtrirë përgjatë gjithë vitit të parë akademik. Përgjatë të dy semestrave praktikës i janë dedikuar 12 kredite, ndërsa punimi i diplomës ka në total 18 kredite nga të cilat 6 janë parashikuar të realizohen në Sem I të vitit të dytë dhe 12 në Sem II të po këtij viti. (<i>Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike</i>.) GVJ, duke patur në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi, nuk e konsideron zhvendosjen e praktikës nga viti i parë në vitin e dytë si një rekomandim të detyrueshëm, megjithatë, GVJ këshillon që në mbështetje dhe të eksperiencave ndërkombëtare, të shikohet mundësia që praktika mësimore të realizohet në vitin e dytë.</p>

<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Nuk aplikohet në rastin e këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Bazuar në RVB, thuhet se "Aktet nënligjore që sigurojnë përmbushjen e këtij kriteri dhe normojnë nivelin e përputhshmërisë nuk janë shpallur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, por mbetet një nga hapat e radhës në përmbushje të Nenit 86 të LAL 80/2015". (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike).</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Përmes shkresës me Nr. 60 prot datë. 31.03.2023 institucioni ka realizuar procesin e kodifikimit të programeve dhe ka njoftuar Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (Evidenca Nr. 31.3. Shkresë UET_propozimet për kodifikimin e programeve të studimit). Bazuar në RVB për programin e ciklit të dytë, "Master i shkencave" në "Shkenca Politike" institucioni ka propozuar kodin 75MS-0312-S, me argumentimin: bazuar në kurrikulën dhe rezultatet e të nxëniet të tij, fusha e programit të studimit sipas ISCED-F 2013: Shkenca politike dhe civile. (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike)</p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me</p>	<p>Në kuadër të Projektit Erasmus+ KA2 për Ngritjen e Kapaciteteve, Projekti 561485 - 2015-2017, "Zhvillimi i Kurrikulës së Përbashkët në Master i Shkencave Politike Evropiane (MShPE)", UET ofron një program të përbashkët Master i Shkencave në Shkenca Politike -</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 123

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




legjislacionin në fuqi.	Integrimi dhe Qeverisja. Në kuadër të marrëveshjes me institucionet partnere, viti i parë i studimeve ndiqet në një nga institucionet perëndimore (Universiteti i Salzburgut ose Universiteti i Lubjanës) dhe gjatë vitit të dytë të studimeve, studenti ka të drejtë të zgjedhë 1-2 institucione të tjera të rajonit, për të përmbyllur pjesën tjetër të detyrimeve akademike të programit të studimit. Sikundër sqarohet dhe në RVB, në bazë të legjislacionit shqiptar, ky akreditim nuk u konsiderua i mjaftueshëm nga Ministria përgjegjëse për arsimin, UET ngriti grupin e vlerësimit të brendshëm, në zbatim të procedurave vendase për të hartuar raportin në kuadër të zhvillimit të procesit të vlerësimit të jashtëm vendas. (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike, fq.18-19)			
Konkluzione	<p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ evidenton se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore të UET.</i></p> <p><i>GVJ sugjeron që institucioni në vijim të konsiderojë që në kurrikulën e këtij programi studimi, realizimi i "Praktikës profesionale" të ofrohet në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve. Ky sygjerim mbështetet në faktin që përgjithësisht të gjitha programet e studimit në ciklin e dytë e kanë të përfshirë praktikën profesionale në përfundim të formimit teorik të studentit, kjo me qëllimin e mirë të lidhjes së teorisë me praktikën. Gjithashtu ky sugjerim bëhet që studentët të kenë mundësinë për të aplikuar më mirë në praktikë njohuritë e përfituara përgjatë studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Programi i studimit MSH në "Shkenca Politike" me profile "Administrim Publik", "Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara. Veprimtaria e fakultetit dhe departamentit mbështetet në aktet rregullatore të UET dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e parashikuara në këto akte. Departamenti drejtohet nga Përgjegjësi (neni 20.5 deri tek neni 20.5.5 i Statutit të UET përcakton funksionin dhe detyrat e tij) (Evidenca Nr.2 Statuti). Për organizimin e punës krahas akteve në nivel institucional si rregullore Universiteti, Fakulteti dhe Departamenti, departamenti ka miratuar dhe një rregullore të dedikuar




	<p>për programin e studimit Master Shkencor në “Shkenca Politike” (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike</i>). Në këtë dokument janë të përcaktuara detajet dhe specifikimet e programit, qëllimet dhe objektivat e tij, mënyra e organizimit të studimeve, plani mësimor etj. Ky departament përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin, strukturën dhe stafet akademike.</p> <p>Përbërja e Departamentit paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Viti akademik 18-19: 15 PAE (2 Prof.Dr., 2 Prof.As., 7 Dr/PhD. dhe 4 Msc.) dhe 3 PAK (1 Prof.Dr., dhe 2 Msc.); - Viti akademik 19-20: 9 PAE (2 Prof.Dr., 2 Prof.As., dhe 5 Dr.) dhe 5 PAK (1 Prof.Dr., 3 Dr., dhe 2 Msc.); - Viti akademik 20-21: 8 PAE (2 Prof.Dr., 3 Prof.As., 2 Dr. dhe 1 Msc.) dhe 1 PAK (Dr.); - Viti akademik 21-22: 9 PAE (6 Prof.Dr., 2 Prof.As., dhe 1 Msc.) dhe 3 PAK (1 Prof.Dr., dhe 2 Dr.); - Viti akademik 22-23: 10 PAE (4 Prof.Dr., 2 Prof.As., 2 Dr/PhD. dhe 2 Msc.) dhe 2 PAK (1 Prof.Dr., dhe 1 Dr.). <p>(<i>Evidenca Nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP; Tabelat përmbledhëse, tabelat 2</i>)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Angazhimi i personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ është përgjithësisht i përshtatshëm në drejtim të arritjes së objektivave të programit të studimit. Sipas programit mësimor Praktika profesionale fillon që në semestrin e parë të vitit të para akademik dhe shtrihet përgjatë vitit. Në syllabusin e “Praktikës” që mund të jetë dhe lapsus është përcaktuar vetëm në sem II të vitit të parë akademik (<i>Evidenca Nr. 19. Syllabus_n_Praktikë Profesionale</i>). Në kuadër të Praktikës profesionale studenti krahas seancave në auditor kryen praktikë në një institucion/organizatë/ kompani i mbikqyrur nga pedagogu përgjegjës i departamentit. Institucioni ka hartuar dhe një dokument i titulluar “B.I. Mbi praktikën profesionale” ku trajtohen elementët e realizimit të praktikës. (<i>Evidenca Nr. 32.1. Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale</i>)</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në aktet rregullatore të UET është përcaktuar pozicioni i Koordinatorit të programit të studimit. Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit. Ai është gjithashtu përgjegjës për kontrollin e elementëve që lidhet me cilësinë e mësimdhënies (ku përfshihen, syllabuset, tekstet, metodologjia, kontrolli i tezave, i eseve etj). Me vendim Nr. 93, datë 03.12.2018, të Dekanatit të Fakultetit të Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare për programin MSH në “Shkenca Politike” si koordinitor i programit të studimit është caktuar Prof. Asoc.</p>

	Dr. E.I. (Evidenca Nr. 36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit_Detyrat e koordinatorit të programit)			
Konkluzione	GVJ konkludon se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Programi i studimit MSH në “Shkenca Politike”, me profile, është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programit të studimit të ofruar nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar. Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara disponon strukturën akademike dhe administrative, dokumentacionin dhe teknikalitetet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Informacioni dhe teknikalitetet janë të aksesueshme dhe ju vihen në dispozicion stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve që ndjekin këtë program studimi. GVJ konstaton se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe punim diplome të vlerësuara me kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), të cilat zhvillohen në dy vite akademik, të ndarë në dy semestre. (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike). Gjithashtu platforma UET LMS (sistemi i menaxhimit online të mësimdhënies) me të gjitha funksionet e tij, si ngarkimi i literaturës për çdo lëndë, njoftimet e pedagogut, pikët e vlerësimit, dërgimi i detyrave dhe eseve nga studentët realizon informimin në kohë reale të studentëve (Evidenca Nr. 46.1 Urdhër Mbi zbatimin e platformes LMS).
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile, është i ndërtuar mbi bazën e planit mësimor i cili jep informacion të detajuar në lidhje me llojin e veprimtarisë, numrin total të krediteve për çdo lëndë, ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor dhe orë punë individuale për çdo lëndë të programit. Ky program studimi është i organizuar në 2 vite akademike (4 semestra) me një total kreditesh 120 ECTS. Çdo vit akademik përmban 60 ECTS me nëndarje të lëndëve të tipologjisë A, B, C, D dhe E (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike).



	<i>Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike). Gjuha e programit të studimit është Shqip. Në Rregulloren e institucionit, Rregulloren e programit të studimit si dhe në çdo syllabus përcaktohen rregullat për frekuentimin e mësimit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe sistemin e vlerësimit, zhvillimin e provimeve, etj. (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 19. Syllabus)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i Rregullores së programit të studimit e dokumentave të tjera të posaçme si dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, GVJ konstaton se në to studentët mund të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit, njohjes së krediteve dhe kushteve të mobilitetit të studentëve. Konkretisht neni 2.1 i Rregullores së programit të studimit MSH në “Shkenca Politike” me profile përcakton se: “Për t’u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave, studenti duhet të zotërojë së paku një diplomë të nivelit të parë (Bachelor) ose një diplomë tjetër të fituar jashtë vendit e të vlerësuar ekuivalente me të. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit European: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. Niveli i njohjes së gjuhës së huaj përcaktohet me akt nënligjor të ministrisë përgjegjëse të arsimit të lartë.” Gjithashtu neni 9 i Rregullores lidhet me transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. (Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 28. Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin)
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Syllabuset e lëndëve që përmban kurrikula e programit të studimit Masteri i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile janë hartuar në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni. Në to paraqitet informacioni i detajuar në lidhje me objektivat e lëndës, temat për secilën javë, formatet e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. (Evidenca Nr. 19. Syllabus)
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërehet se përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Bazuar në RVB: “përditësimi dhe rifreskimi i syllabuseve duke përfshirë në to informacion të ri realizohet çdo vit” (Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike). Pasurimi i bibliotekës me libra të dedikuara lëndëve të këtij program studimi është i domosdoshëm. Nga shqyrtimi i dokumentit “Inventari i teksteve Shkenca Politike” vërehet se pak tituj janë literaturë e viteve të fundit. GVJ sugjeron pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave dedikuar këtij program studimi. (Evidenca Nr. 45. Inventari i teksteve shkenca politike)

Konkluzione	<i>GVJ konkludon se programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë të studimit. Në kuadër të përditësimit dhe përmirësimit të programit të studimit, GVJ sugjeron që institucioni të vijojë me pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit për programin e studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile konstatohet se emërtimi dhe përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe detyrimet përmbyllëse, mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe punësimin e studentëve. Ato janë të organizuara në 5 kategori (A-E), si: lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinare/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, me vlerësimin përkatës në orë mësimore e kredite (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike</i>). Kurrikula ka të integruar komponentët teorik me ato praktik. Në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse. Gjithashtu përgjatë gjithë vitit të parë të studimeve, studentët realizojnë praktikën profesionale. Në vitin e fundit krahas lëndëve realizojnë dhe detyrimet përmbyllëse (<i>Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike</i>). Për t’u diplomuar nga ky program Master i Shkencave, një student duhet të fitojnë së minimalisht 120 ECTS në të gjitha komponentët në përputhje me shpërndarjen e tyre.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	GVJ vlerëson se organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile, mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifike të programit të ciklit të dytë të përcaktuar në Rregulloren e tij (<i>Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike</i>). Departamenti realizon një dokument të titulluar “Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP” për të parë ecurinë e programit. (<i>Evidenca Nr. 38. Analiza e departamentit për arritjen e objektivave formues SHP</i>) Shpërndarja e lëndëve realizohet përkatësisht në 4 semestra të shtrira përgjatë 2 viteve akademike, me kreditet e orët

	<p>mësimore përkatëse, përputhet me përcaktimet ligjore në fuqi dhe është në funksion të objektivave formues të programit e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit të studentëve. Praktika Profesionale për programin Master Shkencor realizohet në vitin e parë. Praktika ka 12 kredite dhe është e shtrirë përgjatë gjithë vitit të parë. <i>(Në raport në këtë kriter ka një pasaktësi ku thuhet se "është realizuar gjatë semestrit të dytë"). (RVB fq.24)</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike", me profile, është program studimi që ofrohet për një kohëzgjatje 2 vjeçare, me 120 ECTS. Struktura e programit është e mirë-gërshetuar ku lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë është në harmoni të plotë me atë çka kërkon një program i një niveli "master" si në nivelin kombëtar dhe atë rajonal. Syllabuset dhe planet mësimore përcaktojnë qartë dhe në mënyrë eksplicite emërtimi, ngarkesa në kredite, raporti teori/praktikë të lëndës apo modulit. <i>(Evidenca Nr. 14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 19 Syllabus)</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit bën të mundur arritjen e objektivave formuese të studentit <i>(Evidenca Nr. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca Politike)</i>. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik në përfundim të studimeve i shërben arritjes së objektivave të zhvillimit profesional dhe aftësimit për tregun e punës. Syllabuset e lëndëve në programin e studimit kanë rubrikën e kontrollit të dijeve të ndarë në: pjesëmarrjen aktive në auditor, detyra përgjatë semestrit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar <i>(Evidenca Nr. 19 Syllabus)</i>. Gjithashtu, programi mundëson transferimin e studimeve, mobilitetin e studentëve, sikurse dhe punësimin e tyre pas përfundimit të studimeve pasi programi i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme. Departamenti organizon dhe koordinon praktikën profesionale që realizohet përgjatë gjithë vitit të parë akademik. Programi përmbillet me realizimin e punimit të diplomës.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Syllabuset janë në përputhje me vendimet ligjore duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vërejtje përfundimtare nga pedagogu. Në mënyrë periodike, institucioni u kërkon pedagogëve përditësimin e syllabuseve <i>(Evidenca Nr. 19 Syllabus)</i>. Referuar literaturës së detyruar apo ndihmëse vendase dhe të huaj në një masë të madhe është e përditësuar me literaturë të viteve të fundit. <i>(Evidenca Nr. 19 Syllabus)</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimn e dijeve, aftësive dhe kompetencave</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit garanton formimin e aftësive dhe kompetencave profesionale për studiues dhe ekspert të fushës së Shkencave Politike. Nga shqyrtimi i syllabuseve GVJ konstaton se, me</p>

të synuara.	përmbajtjen e tyre, ato synojnë përfitim të dijeve, aftësive e kompetencave që ka si objektiva ky program studimi. (Evidenca Nr. 14 Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 19 Syllabus; Evidenca Nr. 7 Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit dhe syllabuseve të lëndëve, GVJ konstaton se ky program u ofron studentëve njohuri të specializuara dhe të thelluara në fushën e Shkencave Politike, siç është strukturuar e profilizuar programi, duke u dhënë mundësi studentëve të marrin baza për të vijuar me studime të mëtejshme, apo të shfrytëzojnë aksesin në tregun e punës. (Evidenca Nr. 14 Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 19 Syllabus; Evidenca Nr. 7 Rregullore e Programit_MSH_Shkenca Politike)			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike" me profile është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve si dhe të kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Evidenca Nr. 12.1 Bordi i Tregut të Punës – DSHSA), rezulton se, në nivel departamenti, organizohen Bordet e Tregut të punës. Kjo strukturë ka në përbërje 11 anëtar të cilët janë me pozicione pune të ndryshme si: drejtues, administrator sipërmarrjesh private apo institucioneve publike, etj. Sikundër konstatohet dhe nga proces-verbali i datës 8.03.2022 pika nr. 2 lidhet me "Diskutimi në lidhje me kurrikulat e programeve të studimit" (Evidenca Nr. 12.2 Mbledhje BTP_08.03.2022). Nga dokumentacioni dhe vizita në institucion rezulton se Bordet konsultohen për programet e studimit dhe planet mësimore, për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. Në tërësi, institucioni bazohet në Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve të tij nënligjore si dhe ka një kuadër të plotë dokumentacioni si statut, rregullore, strategji etj që orientojnë procesin e krijimit apo përmirësimin të përmbajtjes së programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe	Në statutin e UET (neni nr.51) është përcaktuar që, në nivel njësie



Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>strukturat e tyre. mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar. për përmirësimin e programit të studimit. dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>kryesore, vepron si strukturë Këshilli Studentor. Studentët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha çështjet me interes të institucionit, si planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, cilësinë e shërbimeve dhe zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike e sportive. Institucioni i mbështet në logjistikë dhe mund të financojë projekte të tyre. (Evidenca Nr. 2 Statuti UET_struktura organizative aktuale) Studentët përfaqësohen në Senatën Akademik, KSBC, Këshillin e Etikës. Studentët, sipas programit, marrin pjesë në mbledhjet e hapura një herë në muaj të Departamentit, ku u jepet mundësia të bëjnë diskutime e sugjerime në funksion të përmirësimit të programit të studimit. UET ka si parim që studenti “të ketë hapësirën maksimale për t’u bërë aktor i formimit të vet profesional”. Gjithashtu në marrëdhënie me studentët institucioni ka si prioritet, organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjeteve ALUMNI që funksionojnë pranë tij. (Evidenca Nr. 3 Plani Strategjik UET 2021-2025; Evidenca Nr. 17. Studim periodik i tregut të punës)</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Institucioni ka në fokus bashkëpunimin dhe partneritetet me universitete të tjera dhe është pjesë e rrjeteve dhe projekteve të bashkëpunimit universitar, shkencor e akademik me universitetet në BE, organizata qeveritare e joqeveritare. Në planin strategjik 2021-2025 cilësohet se: “UET mbështet fuqishëm Zyrën për Zhvillimin e Projekteve dhe Kërkimit” me qëllim rritjen e projekteve dhe kërkimit të orientuar ndaj politikave dhe aktiviteteve për zhvillimin e stafit dhe cikleve të studimit etj (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025, fq.9) Programi i studimit është në koherencë me zhvillimet e fundit në fushën e shkencave politike.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se institucioni ka një eksperiencë tejet pozitive në rritjen e bashkëpunimit me universitete Europiane dhe më gjërë si në fushën e shkëmbimit dhe atë të projekteve të tjera duke ndikuar që ky program të përmirësohet edhe më tej.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Në të gjitha nivelet institucioni ka hartuar dokumenta strategjik ku përfshihen qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të programit të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të tij. (Evidenca Nr. 3. Plani Strategjik UET 2021-2025; Evidenca Nr. 3.1 Strategjine e Kerkimit Shkencor UET (2021-2025) Evidenca Nr. 4 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca</p>

	<p><i>Politike</i>). Njësia bazë (departamenti) ushtron kompetenca në bazë të parashikimeve ligjore, si dhe organizon dhe bashkërendon punën institucionale dhe akademike. Realizimi i këtij synimi kërkon zhvillimin e një bashkëpunimi akademik në fushën e formimit teorikë dhe profesional, të kërkimit shkencor si edhe në fusha të tjera me interes të ndërsjelltë. (Evidenca Nr. 7 Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr. 6 Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit dhe Raportin e Vlerësimit të Brendshëm, rezulton se njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare, është i përbërë nga tre departamente: 1-Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara; 2-Departamenti i Shkencave Juridike; 3-Qendra për Metodologjinë dhe Kërkimin Shkencor. (Evidenca – në sistem rubrika “Aplikimi, kontrolli i të dhënave institucionale dhe i programit të studimit”) Njësia kryesore bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies e ato kërkimore të njësive bazë. Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara nxit, programon, bashkërendon, zhvillon e organizon, në nivelin e programit të studimit, punën akademike e kërkimore. Zbatimi i rregulloreve të programeve të studimit që mbulon departamenti përmban respektimin e lirisë akademike, si dhe të drejtave dhe detyrimeve e stafit akademik dhe të studentëve.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Institucioni përmes kuadrit rregullator, dokumenteve strategjike, marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe vizionit të tij synon që në kuadër të realizimit të programeve të studimit të nxit, mbështet dhe angazhojë në projekte, mobilitete apo në aktivitete kërkimore studentët dhe stafin akademik. (Evidenca Nr. 28.5 Staf dhe Studentë në projekte aktive në UET – DSHSA; Evidenca Nr.43.7. Angazhimi i Studentëve në Kërkimin Shkencor 2018-2022; Evidenca Nr. 55.2. Kalendari i aktiviteteve 2022-2023) Në programet mësimore (syllabuset) detyra e kursit i mundëson studentit realizimin e një punë kërkimore plotësuese. Gjithashtu përmbyllja e studimeve me punim diplome angazhon studentët në thellimin e dimensionit kërkimor. (Evidenca Nr. 14.2. Plani mësimor MSH Shkenca Politike)</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Institucioni mbështet financiarisht organizimin e konferencës shkencore ndërkombëtare “Ditët e Studimeve Shqiptare Junior” (Evidenca Nr. 55 Ditët e Studimeve Shqiptare (DSSH) 2018-2023). Gjithashtu, përgjatë vitit akademik, në nivel institucional organizohen aktivitete të ndryshme me fokus informim, rritje kapacitetesh, aktivitete studimore etj. (Evidenca Nr. 55.2 Kalendari i aktiviteteve 2022-2023). Institucioni ka praktika të mira për realizimin sa më efektiv të programit të studimit dhe dhënies së mbështetjes financiare si për stafin akademik atë administrativ dhe për studentët.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludon se strukturat përgjegjëse si njësia kryesore dhe ajo baze bëjnë të mundur realizimin e programit të studimit të lidhur me</i></p>




	<i>orientimin dhe fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi realizon objektivat e vendosura në dokumentet strategjike të zhvillimit institucional dhe kërkimi shkencor në përputhje me fushën e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Projektet e Mëdha Kërkimore (pika 7 e Strategjisë së Kërkimit Shkencor 2021-2025) përbëjnë shtyllën e kërkimit shkencor në UET, me synim ndër-disiplinaritetin e kërkimit. Ato janë instrumenti kryesor i drejtimit dhe gjenerimit të punimeve dhe botimeve shkencore dhe realizojnë koordinimin e kërkimit shkencor si dhe përdorimin e tij për palët e treta të interesuara në aplikimin e produktit shkencor. <i>(Evidenca Nr. 3.1 Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025)</i> Nga shqyrtimi i dokumentacionit respektiv, rezulton se institucioni bën planifikimin strategjik me projekte që realizojnë në praktikë objektivat strategjike të fushës kërkimore. Planet e Integruara të Kërkimit Shkencor detajohen me afate kohore, me detyra konkrete për njësitë kryesore e grupet kërkimore si edhe ato administrative dhe mbështetëse. Indikatorët e Performancës së Kërkimit Shkencor zhvillohen për ndjekjen e realizimit të synimeve të institucionit, duke shërbyer edhe për ballafaqimin me rezultatet e pritshme që lidhen me objektivat bazë të Strategjisë <i>(Evidenca Nr.3 Plani Strategjik UET 2021-2025)</i> .
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Në vizionin e UET, kërkimi shkencor është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore. Pjesa më e madhe e personelit të brendshëm është e angazhuar në kërkim shkencor dhe drejton grupe kërkimore, ndërsa janë përfshirë në këto procese në nivel grupi edhe studentët të programit MSH "Shkenca Politike" me profile <i>(Evidenca Nr.43.7. Angazhimi i Studentëve në Kërkimin Shkencor 2018-2022; Evidenca Nr. 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca Politike; Evidenca Nr.3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025)</i> . Gjithashtu, një pikë e fortë e institucionit është bashkëpunimi me institucione të tjera jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus ku mundësohet shkëmbimi i studentëve në nivel ndërkombëtar <i>(Evidenca Nr.0 RVB MSH Shkenca Politike)</i> .
Kriteri 3. Në fushën e programit të	Departamenti organizon një sërë aktivitetimesh më karakter studimor, e

studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	kërkimor shkencor të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët në arritjen e objektivave të programit të studimit. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse merr pjesë në një panel të posaçëm në konferencën ndërkombëtar "Ditët e Studimeve Shqiptare" (Evidenca RVB MSH Shkenca Politike).			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Kurrikula dhe përmbajtja e programit të studimit Master i Shkencave në "Shkenca Politike", me profile, është i rëndësishëm për vendin dhe proceset zhvillimore të tij. Ky program studimi formon profesionistë konkurrues për tregun e punës (Evidenca Nr.14. Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike).			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Nuk aplikohet për këtë program studimi (Evidenca RVB MSH Shkenca Politike).			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU).	Nuk aplikohet për këtë program studimi (Evidenca RVB MSH Shkenca Politike).			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe vizitat në Institucion, vërtetohet se institucioni realizon planifikimin strategjik, si dhe implementimin e projekteve që synojnë realizimin në praktikë të objektivave të fushës kërkimore-shkencore. GVJ konkludon se programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Programi i studimit përqipet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive siç janë leksionet, seminarat, apo detyrat e kursit, të cilat gërshetohen me diskutim aktiv, punë në projekte si individuale ashtu edhe në grupe por edhe zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, Kreu Y, neni 45 pika 5</i>). Në fund të semestrit studentët dorëzojnë papers, ese mbi lëndët e zhvilluara bazuar edhe në artikuj të marra nga literatura shkencore (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 17</i>). Për të siguruar një rezultat sa më të lartë në mësimnxënie pedagogët ofrojnë një larmi metodash sic janë projektet në grupe, prezantimet individuale, etj (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 3.1</i>). Këto forma janë mbështetur edhe me infrastrukturën përkatëse në nivel insitucional si edhe në kontributin e aktorëve të tregut të punës me ndihmën e të cilëve Departamenti ka zhvilluar edhe leksione të hapura (<i>Evidenca Nr. 12.1, Bordi i Tregut të Punës</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format dhe mënyrat e mësimdhënies për çdo lëndë janë të specifikuar në syllabusin e lëndës në përputhje me legjislacionin në fuqi duke përfshirë metodat pedagogjike të përdorura në seminare, literaturën e detyrueshme dhe atë të rekomanduar etj. (<i>Evidenca Nr. 19, Syllabuset e Lëndëve të ofruara për Programin MSH në Shkenca Politike</i>). Për zhvillimin e lëndëve në auditor përdoren si mjetet infrastrukturore ndihmëse ashtu edhe metodologjitë e diversifikuara të mësimdhënies të cilat përfshijnë diskutimet në grupe, projekte në një skuadër, të cilat nxisin një analizë të plotë të rasteve të marra në studim si edhe mendimin kritik.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>IAL edhe departamenti përkatës mbështesin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke shfrytëzuar metodat bashkëkohore me synim rritjen e vazhdueshme profesionale të pedagogëve dhe ofrimin e stimuljeve për përmirësimin profesional (<i>Evidenca Nr. 43, Të dhënat mbi kërkimin shkencor të stafit të programit</i>). Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) trajnime të strukturuar sipas nivelit shkencor për pedagogët me qëllim rritjen e mëtejshme të cilësisë profesionale, si përsa i takon metodologjive profesionale ashtu edhe për njohjen e rregulloreve të UET në lidhje me organizimin dhe</p>




	<p>zhvillimin e mësimit; c) IAL organizon në mënyrë periodike Staff Development Day, aktivitet që fokusohet në trainimin e stafit me format e mësimeve, kërkimit shkencor apo zbatimin të projekteve ndërkombëtare; d) Back to Work është një training dy-ditor që organizohet për stafin në fillim të çdo viti akademik (<i>Evidenca Nr. 33, Të dhënat për traininget profesionale të stafit</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësime në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimeve interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Përzgjedhja e pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi bëhet nga një grup pedagogësh ku bën pjesë Përgjegjësi i departamentit, i cili përfshihet si në procesin e rekrutimit të personelit akademik, ashtu edhe në vlerësimin periodik të pedagogëve të njësisë (<i>Evidenca Nr. 11, Dokumenti G, Rregullore për Burimet Njerëzore</i>). Kjo përzgjedhje është publike dhe zhvillohet nëpërmjet një konkursi ku konsiderohet eksperiencë e kandidatit në mësime, kualifikimet, si edhe gradat shkencore (<i>Evidenca Nr. 11, Dokumenti G, Rregullore për Burimet Njerëzore</i>).</p> <p>Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i njohur nivelin e përkurisë akademike si studentë masteri duke organizuar aktivitetet shkencore me ta falë gërshtimit të metodave interaktive apo audiovizuale që përfshihen jo vetëm në procesin e seminareve por edhe në leksione ((<i>Evidenca Nr. 19, Syllabuset e Lëndëve të ofruara në Programin e Studimit; Takim me Stafin Akademik</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimeve në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin e mësimeve nga instanca të ndryshme të cilat mund të përmbledhen në vlerësimin nga:</p> <p>a) Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për organizimin e punës didaktike dhe zhvillimin strategjik të departamentit. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, kontrollit të cilësisë së syllabuseve, harmonizimit të ngarkesës së stafit akademik, ndihmës që i ofrohet stafit të ri, trainingit për përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimin të performancës së stafit akademik, etj (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, Kreu X, neni 42</i>);</p> <p>b) Vlerësimi nga studentët është një tjetër formë e cila synon dhënieve të sugjerimeve për përmirësimin e cilësisë. Për këtë qëllim ekziston një pyetësor i vecantë, i cili plotësohet duke analizuar përshtypjet nga pjesëmarrja në leksionet e pedagogut që vlerësohet.</p> <p>Vlerësimet e studentëve por edhe ai i Përgjegjës të Departamentit janë pjesë e raportit vjetor dhe i vihen në dispozicion pedagogëve përkatës (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, Kreu X, neni 44</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimeve, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në</p>	<p>Komisioni i Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (KSBC) është struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimeve në nivel institucional (<i>Evidenca Nr. 8, Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>). Anëtarët e Komisionit propozohen nga rekori dhe miratohen nga Senati Universitetit (<i>Evidenca Nr. 30.4</i>,</p>

<p>kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p><i>Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC).</i></p> <p>KSBC është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmesh si: 1) Vlerësimet periodike të veprimtarive mesëimore dhe kërkimore të pedagogëve, si edhe propozon ndryshimet për përmirësimet e nvojshme duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi (<i>Evidenca Nr. 2, Statuti i UET, neni 16, pika 1</i>); 2) në bashkëpunim me njësitë bazë, KSBC specifikon hapat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie Raporti i vlerësimit që pedagogët bëjnë për njëri tjetrin (<i>Evidenca Nr. 8, Dokumenti F.VII 3, Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>); 3) krijimin e zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore për të integruar në programet e trainimit dhe zhvillimit profesional të pedagogëve (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimt të KSBC</i>); 4) rritja e vazhdueshme e nivelit të studentëve për të përfshirë edhe ata si në procesin e vlerësimit ashtu edhe në atë të propozimeve, vendimarrjes dhe zbatimit të politikave të përmirësimit të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 2, Statuti i UET, neni 16, pika 1</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Një praktikë pozitive janë format periodike të trainimit si staff Development Day dhe Back to Work, të cilat synojnë trainimin e vazhdueshëm të stafit akademik. Institucioni harmonizon një sërë formash të mësimdhënies dhe mësimxënies falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për evidentimin dhe zbatimin e formave sa më të mira të përmirësimit të punës së pedagogëve. Këta të fundit përballen me disa forma vlerësimi, si nga studentët, ashtu edhe nga përgjegjësi i departamentit, për të matur progresin e bërë në drejtim të formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimxënies.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi III.2</p>	
<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në një Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucioni/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve bëhet publike dhe pasqyrohet në syllabuset e çdo lënde, ku në një seksion të vecantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën (<i>Evidenca Nr. 19.1, Formati i Syllabus të Lëndës</i>). Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor/master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më efikas të lëndës. Në përgjithësi lëndët vlerësohen sipas shpërndarjes së mëposhtme: a) paper/provim përfundimtar; b) detyrë kursi ose</p>

	<p>prezantim; c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës (Evidenca Nr. 2, Statuti i UET, neni 24). Kriteri i fundit i shërben pedagogut për të kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme progresin e studentit, si nëpërmjet diskutimeve ashtu edhe detyrave të kursit në klasë (Takim me Stafin Akademik).</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, si metodologjia e testimit dhe vlerësimit të njohurive nga titullari i lëndës apo i modulit gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit (Evidenca Nr. 19, Syllabuset e Lëndëve të ofruara në programin e MSH Shkenca Politike). Studentët informohen për mënyrat e vlerësimit edhe nëpërmjet platformave LMS dhe Teams të vëna në dispozicion nga institucioni (Evidenca Nr. 46.1, Urdher mbi Zbatimin e Platformës LMS; Evidenca 46.4, Video Trainime mbi Sistemin Teams). Këtu përfshihen edhe informacionet lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa më objektiv (Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike neni 14). Shkalla e përvetësimit të njohurive bëhet nga 0-100 pikë të cilat konvertohen në notat nga 4 në 10, si edhe me gërma nga F në A (Evidenca Nr. 2, Rregullore e UET, Kreu V, neni 23-24).</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim (Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike pika 5.2). Në këtë program mënyrat më të frekuentuara të kontrollit të mësim-nxënies janë kryesisht punimet shkencore si fokus grupe, detyrat e kursit, të cilat konsistojnë në prezantime individuale apo në grup, analiza artikujsh shkencore për të zhvilluar mendimin kritik (Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike Kreu V neni 23-24). Kjo mënyrë konstante vlerësimi siguron një shpërndarje më të mirë të ngarkesës mësimore gjatë të gjithë vitit për studentët kanë mundësi të njihen në detaje me kërkesat e formave të vlerësimit të përdorura dhe të bëjnë pyetje sqaruese në rast se është e nevojshme (Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike pika 5.2).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshetuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Zbatimi procedurave të testimit të dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe shkencore garantohen si nga stafi akademik ashtu edhe nga platformat online vënë në dispozicion nga IAL.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar. të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e UET përcakton afatet e ndërmjetme (në javën e 7 të semestrit) dhe ato përfundimtare të vlerësimit për kursin, nëpërmjet kalendarit akademik (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 27</i>). Pavarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, testimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndyshëm sic jane pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve dhe provimi përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 17</i>). Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke e mbajtur të fshehtë emrin e studentëve nëpërmjet sistemit elektronik (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 5.3</i>). Pedagogu i dorëzon provimet e korrigjuara në sekretarinë mësimore (<i>Evidenca Nr. 9, Dokumenti mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika F.1.8.6</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet tek transparenca dhe kontrolli i vazhdueshëm i njohurive. UET aplikon sistemin “Clean Scoring”, ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit që përfshijnë: a) Tabelat e vlerësimit dhe ekuivalencës së notave (e përfshirë në syllabuset e lëndëve); b) Sistemin Turnitin që përdoret për të shmangur plagjaturën. Të gjitha papers, ese apo të tjera punime të studentëve kalojnë nëpërmjet këtij sistemi dhe niveli i plagjaturës nuk duhet të kalojë 20%. Kjo i mundëson pedagogëve që jo vetëm të evidentojnë rastet e plagjaturës, por edhe të bëjnë sugjerimet përkatëse për studentët (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 5.5</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabuseve përkatës për çdo lëndë dhe duke marrë parasysh përqindjet në vlerësimin përfundimtar të secilit element të testimit të lëndës siç u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për çdo element vendosen në një rubrikë të veçantë të syllabus, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të çdo lënde (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 5.2</i>). Një kopje e syllabusit i dërgohet me email çdo studenti (<i>Evidenca Nr. 46.1, Urdhër mbi Zbatimin e Platformes LMS</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit</p>	<p>Vlerësimit të studentit i bashkëngjitet feedback i pedagogut i përcjellë përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e</i></p>




për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<i>Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 5.2).</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Falë rregullores së provimeve pedagogët sigurojnë që procedura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe së bashku me specialistin IT krijojnë dritaren ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara, si dhe zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkelin etikën akademike (<i>Evidenca Nr. 7.2, Dokumenti mbi Sistemin e Vlerësimit të Studentëve, pika A.IV.2.6</i>). Sistemit Turnitin kundër plagjiaturës i nënshtrohen të gjithë punimet e studentëve. Plagjiatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët, në mënyrë që studentët të informohen si duhet ta shmangin plagjiaturën, çfarë përbën plagjiaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore (<i>Takim me Stafin Akademik</i>). Si plagjiatura ashtu edhe kopjimi dënohen me notën 4 (<i>Evidenca Nr. 7.2, Dokumenti mbi Sistemin e Vlerësimit të Studentëve, pika A.IV.2.6</i>).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Siç u përmend edhe më lart, ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive personale të studentëve, duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndvështrim kritik. Rregullorja përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore, pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik, ndërsa vlerësimi për elementët e tjerë të testimit që janë zhvilluar me pare, kryhet përpara provimit përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 1.9, Rregullore e Departamentit neni 23</i>). Ky informacion pasqyrohet në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e IAL. Kalendari siguron një zbatim në kohë të të gjitha proceseve të vlerësimit si nota, dhënia e feedback, kontrolli i notave, si edhe kohën procedurale për ankimimin e notës (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 27, pika 9</i>).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një sqarim lidhur me vlerësimin me notë (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 32, pika 9</i>).
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rast se studenti nuk mbetet i kënaqur nga ky sqarim, atëherë mund të drejtojë një kërkesë me shkrim Përgjegjës të Departamentit, i cili ngre një komision prej tre pedagogësh për rivlerësimin e elementit të ankimuar, ndërsa vlerësimi i komisionit është përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 32</i>). I gjithë procesi është transparent në të gjitha fazat e tij.
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nëpërmjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që</i>




	bëhet përpara çdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacione u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit, dhe kurrikula e programit është hartuar duke mbajtur në konsideratë zhvillimet bashkëkohore falë edhe profilit akademik të pedagogëve, shumica e të cilëve janë doktoruar jashtë vendit duke krijuar mundësi që këto njohuri të mund të pasqyrohen edhe në lëndët përkatëse, në programin didaktik që vihet në dispozicion të studentëve duke konsideruar edhe nevojat e tregut të punës (<i>Evidenca Nr. 4, Plani Strategjik për Zhvillimin e MSh Shkenca Politike</i>). Azhurnimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën dhe me format bashkëkohore të mësimdhënies garanton përfitimin e njohurive duke gërshtuar analizat konceptuale në fushën e studimit me formimin kërkimor të përgjithshëm në përputhje me kërkesat e programit të studimit (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit MSH Shkenca Politike</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit parashikon që transmetimi i njohurive tek studentët, të kryhet nëpërmjet angazhimit të tyre direkt në kërkimin shkencor duke i drejtuar në mënyrën si të kryejnë kërkimin shkencor, duke përfshirë si njohurive metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet mini-eseve, detyrave të kursit apo edhe zhvillimit të mendimit kritik të studentëve (<i>Evidenca Nr. 14, Kurrikula e programit MSH Shkenca Politike</i>). Si për të arritur një nivel të lartë kërkimi ashtu edhe për prezantimin e punës së kryer duke harmonizuar elementët analitikë të disiplinave përkatëse, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit) ndërsa aftësitë sociale dhe soft-skills zhvillohen kryesisht nëpërmjet projekteve apo edhe punës në grup (<i>Evidenca Nr. 4, Plani Strategjik për Zhvillimin e MSh Shkenca Politike</i>). Programi është licensuar në gjuhën shqipe ndërsa një pjesë e lëndëve ofrohen edhe në anglisht për studentët Erasmus, si pjesë e strategjisë së UET për të patur deri në fund të vitit 2025, 25% të lëndëve të çdo programi studimi në gjuhën angleze (<i>Evidenca Nr. 3, Plani Strategjik i UET 2021-2025, pika 1.2</i>). Syllabuset e lëndëve dhe lioteratura bazë plotësuese në programet

	master ofrohet si në gjuhën shqipe ashtu edhe në gjuhën angleze (Evidenca Nr. 19.1, Formati i Syllabus Shqip/Anglisht).
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik së bashku me aftësitë ndërvepruese, si për shembull soft-skills apo në teknologjitë ICT që analizohen nga pedagogu në përfundimin e lëndës apo të semestrit sqarohen në seksionin e syllabus “Përmbledhje dhe Qëllimet e Kursit” (Evidenca Nr. 19, Syllabuset e Lëndëve të Programit të Studimit). Pedagogët kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime si edhe në reflektimet e departamentit ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët (Takim me Stafin Akademik). Kjo analizë e njohurive të përfituara por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentit për ti adresuar sugjerimet në vijim të studimit akademik (Takim me Studentët e Programit).
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato: ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Realizimi i lëndëve dhe programeve realizohet duke u bazuar kryesisht në kompetencat: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë siç është literatura e rekomanduar, si edhe informacioni nëpërmjet motorëve të kërkimit siç janë google scholar (Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, pika 5.7.2). Për një cilësi sa më të lartë të mësimdhënies, personeli akademik nxitet nëpërmjet stimuluesh financiarë që të bëhet pjesë e projekteve, të publikojë në revistat shkencore me faktor impakti si edhe të bëhet pjesë e grupeve kërkimore të ngritura në bazë institucioni (Evidenca Nr. 3, Plani Strategjik i UET). Në aspektin praktik realizohet në koordinimin e pedagogut zhvillohen diskutime në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra (Takim me Stafin Akademik dhe me Studentët e Programit). Një tjetër element në këtë drejtim është edhe praktika profesionale e cila është një detyrim në çdo program studimi për të mundësuar një integrim sa më të mirë të studentëve në tregun e punës (Takim me Studentët e Programit). Mobiliteti i studentëve si në ardhje ashtu edhe në dalje nxitet nga zhvillimi i programit në gjuhën angleze (Evidenca Nr. 32.1, Dokumenti 8.1 mbi Praktikën Profesionale).
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Në përputhje me Kalendarin e aktiviteteve të departamentit, personeli akademik organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe me stakeholders të tjerë partnerë të UET apo IAL vendase dhe të huaja duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogoet (Evidenca Nr. 55 1-2, Kalendar i Aktiviteteve).
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pedagogët promovojnë pjesëmarrjen me prezantime të pedagogëve dhe studentëve në aktivitetet shkencore për të inkurajuar më tej idetë e tyre inovative bazuar në “Strategjinë e Kërkimit Shkencor të UET 2021-2025” (Evidenca Nr. 31, Strategjia e Kërkimit Shkencor të UET 2021-2025).

Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, praktikave profesionale, por edhe falë mobilitetit të pedagogëve të huaj apo edhe të UET. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet akademike dhe në ato kërkimore synon zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale dhe shkencore. Një praktikë pozitive është fakti që programi është licensuar në gjuhën shqipe ndërsa një pjesë e lëndëve ofrohen edhe në anglisht për studentët Erasmus, si pjesë e strategjisë së UET për të patur deri në fund të vitit 2025, 25% të lëndëve të çdo programi studimi në gjuhën angleze.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmblylëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e programit të studimit (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit të Studimit MSH Shkenca Politike, neni 8, pika 1</i>) përcakton procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmblylëse dhe projektin e diplomimit dhe konkretisht: <ul style="list-style-type: none"> a) Studentët duhet që fillimisht të përmblyllin të gjitha detyrimet për cdo modul të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin; b) Punimi përfundimtar konsiston në një thesis të cilën studentët fillojnë ta hartojnë në semestrin përmblylës të vitit të dytë të programit ose në një provim përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 39</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmblylëse.	Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmblylëse, formatet e tezës, procedurat e miratimit të temës së diplomës si edhe seancat metodologjike deri tek mbajtja përfundimtare (<i>Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe	Departamenti ngrë një komision të posaçëm me anëtarët e departamentit për administrimin e punimeve të thesis (dizertacionit) (<i>Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit; Evidenca nr. 5, Rregullore e UET neni 39, pika 1.b</i>). Ky komision vlerëson dhe ofron feedback për cdo punim, përpara se të shpallet nga departamenti data e mbrojtjes me gojë të dizertacioneve




peshës specifike.	<i>(Evidenca Nr. 7.2, Dokumenti për Sistemin e Vlerësimit të Studentëve, pika A.IV.2.3).</i>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo njëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Studentët mund të zgjedhin ndërmjet pedagogëve të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e thesis që mendojnë. Nëse nuk ka një pedagog të brendshëm me kompetencat e nevojshme atëherë mund të caktohet një pedagog i jashtëm. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej tema e thesis/dizertacionit. Përcaktimi i udhëheqësit dhe temës i hap rrugën aprovimit të procedurës nga ana e departamentit dhe drejtuesit të tij <i>(Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit, pika 4.1).</i></p> <p>Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë me kerkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi. Ky i fundit vendos kur punimi është i gatshëm për tu dorëzuar në komisionin e vlerësimit duke garantuar cilësinë shkencore të dizertacionit <i>(Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit, pika 5.2).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda IAL për hartimin e dizertacionit, udhëheqësi ofron, kur është e nevojshme ndihmë shtesë nëpërmjet netëork personal jashtë institucionit duke krijuar mundësinë që studentit të marrë ekspertizën e nevojshme për një punë sa më cilësore <i>(Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit, pika 5.8).</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti vlerësohet me notë për tezën apo provimin përfundimtar, ku vlerësimi duhet të jetë mbi 50% për tu vlerësuar si i kalueshëm dhe për të mundësuar studentit pajisjen me diplomë <i>(Evidenca Nr. 10, Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit).</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Pasi ka plotësuar kërkesat e planit mësimor dhe përmbyllur të gjitha detyrimet akademike duke përfshirë edhe temën përfundimtare, cka vlerësohet nga Sekretaria Mësimore, studentit pajiset nga IAL brenda 6-mujsh me diplomën përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave të marra gjatë studimeve, si edhe me suplementin e diplomës të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm <i>(Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 40, pika 1).</i></p> <p>Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e Masterit Shkencor dhe me suplementin e diplomës në shqip dhe në anglisht, ndërsa forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA) <i>(Evidenca Nr. 10,</i></p>




	<i>Dokumenti B.II. Mbi Punimin e Diplomës dhe Disertacionit, pika 1, 2, 3).</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Pas diplomimit, Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e dosjes personale të studentëve si edhe regjistrin themeltar me të dhënat e tyre - si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike pa afat - në arkivin e universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore e UET, neni 40, pika 2</i>). Këto të dhëna përpunohen dhe vihen në dispozicion sipas kërkesave të ministrisë përkatëse, ASCAL, apo nevojave të institucionit për të bërë studimin e rezultateve të arritura (<i>Takim me Sekretarinë Mësimore</i>).			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin si nga këshilltari akademik ashtu edhe nga udhëheqësi i tezës finale. UET e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën, ashtu edhe diploma suplement.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<i>Ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi.</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë	

studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.				
Konkluzione				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Bazuar në shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, vizitën e realizuar në institucion, bisedat me stafin akademik dhe me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konfirmon se UET dhe më specifikisht në programin MSH “Shkenca Politike” ka të angazhuar personelin akademik me tituj, grada dhe në proces doktore. Gjithashtu duhet theksuar se <i>në vitin akademik 2022-2023 në procesin e mësimdhënies (orë seminari) janë angazhuar dhe staf me Master Shkencor të cilët janë në proces doktore.</i> Në zbatim të akteve ligjore në fuqi (specifikisht neni 59 pika 6 e Ligjit Nr. 80/2015 përcaktohet se: “Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës) si dhe në respektim të standardeve më të larta të mësimdhënies, <i>GVJ thekson se në ciklin e dytë të studimit institucioni të angazhojë staf akademik me të paktën gradën Doktor Shkencash.</i> Theksojmë se përgjatë 5 viteve akademike të zbatimit të këtij programi studimi përfshirja e stafit me Msc është bërë vetëm në vitin akademik 2022-2023, ndërsa në vitet e mëparshme është zbatuar përfshirja e stafit me kualifikim të ciklit




pasardhës sikundër e kërkon legjislacioni në fuqi. (Evidenca CV e stafit akademik të programit të studimit). Në realizimin e programit të studimit, përgjatë viteve akademike 18-19 deri në 22-23 është angazhuar stafi akademik me kualifikimin si në vijim:

Tituj/ grada	22-23		21-22		20-21		19-20		18-19	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	1	2	-	2	-	2	-	3	-
Prof.Asoc.	1	-	2	-	2	-	3	-	3	-
Dr./PhD.	7	2	4	1	5	2	3	2	3	1
Msc.	1	1	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	11	4	8	1	9	2	8	2	9	1

Për të dhënat e paraqitura sa më lart, GVJ i është referuar të dhënave sikurse paraqitur nga IAL në tabelat përmbledhëse (tabelat 6 dhe tabelat për vitin akademik 22-23).

Nga shqyrtimi i CV-ve të stafit rezulton se profili i ekspertizës së stafit akademik është në përshtatje me lëndët e këtij ofruara në këtë program studimi. Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik janë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin. Në këtë program studimi si staf i departmentit (kategoria Profesor) janë të përfshirë 2 Prof.Dr. dhe 1 Prof.Asoc të cilët mbulojnë lëndët bazë të profilit të studimit.

Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit, evidentohet se jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", sikurse kërkohet nga neni 59, pika 3 e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Për sa më lart, GVJ rekomandon që IAL të caktojë si titullarë lëndësh, personel akademik të kësaj kategorie.

(Evidenca Tabelat përmbledhëse, tabelat 6 dhe tabelat për vitin akademik 22-23; CV e stafit akademik të programit të studimit (Ref. Nr. 20; Ev. 19, syllabuset)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Shpërndarja e ngarkesës mësimore realizohet bazuar në planin e miratuar në fillim të çdo viti akademik. Të dhënat tabelare për 5 vite akademike tregojnë se ngarkesa mësimore për këtë program studimi është përbulluar në pjesën më të madhe nga stafi akademik me kohë të plotë, si dhe në program është përfshirë dhe staf akademik me kohë të pjesshëm. (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks RVB




	<p><i>MSH_SHP)</i></p> <p>Mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik në këtë program studimi, për pesë vitet e fundit akademike paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - viti akademik 18-19: 93 % PAE / 7 % PAK; - viti akademik 19-20: 86 % PAE / 14 % PAK; - viti akademik 20-21: 88 % PAE / 12 % PAK; - viti akademik 21-22: 90 % PAE / 10 % PAK; - viti akademik 22-23: 78.1 % PAE / 21.9 % PAK. <p>GVJ, për paraqitjen e të dhënave si më lart, i është referuar tabelave sikurseve paraqitur nga IAL (tabelat 12/1, 12/2, 12/3, 12/4; tabelat për vitin akademik 22-23).</p> <p>GVJ konfirmon se, për këtë program studimi, personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ngarkesën mësimore.</p> <p>Përgjithësisht ngarkesa mësimore varion nga 90 orë deri në 300 orë konform legjislacionit në fuqi (Udhëzimi Nr.29 datë 10.09.2018 MASR). (Evidenca Nr. 0.2. Tabelat përmbledhëse për Aneks_RVB MSH_SHP).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Për periudhën e akreditimit, dëshmohet qëndrueshmëri e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit MSH “Shkenca Politike”, me profile. Kjo konstatohet nga shqyrtimi i dosjeve të stafit akademik dhe dokumentacioni në lidhje me kontratat e punës etj. Dosjet e personelit të vëna në dispozicion gjatë takimit me ZBNJ përfshijnë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë personelin akademik. (Evidenca Vizita në institucion - Minuta takimi Msc. Shkenca Politike me profile dhe Msc. Marredhenie Nderkombetare- UET. fq.9).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Neni 44 i Statutit i titulluar “Personeli Akademik, punësimi dhe vlerësimi” përcakton se “Njësia bazë identifikon dhe propozon nevojën për një vend të lirë...”, miratimi i të cilit realizohet nga Rektori. Gjithashtu neni 10.2 i Rregullores së Universitetit Europian të Tiranës përcakton se Personeli i UET mund të jetë i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.</p> <p>Nga bisedat me stafin akademik dhe nga shqyrtimi i dosjeve, doli qartë se Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procedura të rregullta rekrutimi dhe vlerësimi. Kjo zyrë ka përgjegjësi për zbatimin e kriterëve në rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, që nga kriteret e përgjithshme deri tek kriteret specifike sipas rastit të cilat bëhen publike në faqen zyrtare të UET. Zyra e Burimeve Njerëzore e publikon shpalljen për vendet vakante (Evidenca 11.1 Shembull thirrje</p>




	<p>për staf akademik), duke specifikuar nivelin e kualifikimit, detyrat e vendit të punës, dokumentacionin e kërkuar (CV e hollësishme në gjuhën shqipe, Letër motivimi; Kopje të listës së notave, Kopje të dëshmisë së gradës shkencore/titujve akademikë).</p> <p>(Evidencë Nr. 5 Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës; Evidencë Nr. 11 Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit nuk parashikon orë laboratorike dhe nuk ka nevojë për laboratorë specifikë. UET për vitin akademik 2021 – 2022, e në vazhdim, gjendet në kampusin e ri universitar me adresë Rruga “Xhanfize Keko”, Nd. 56, Në Tiranë. Mjediset e ofruara nga institucioni janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike me 15 salla leksioni dhe 13 salla seminari (Evidencë Nr. 42 Nr. 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vizita në institucion, bisedat me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, shqyrtimin e dosjeve të personelit akademik, GVJ konfirmon se UET ka rregulla të përcaktuara për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe realizon me përgjegjësi mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, atij ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ. Për secilin person të angazhuar në UET, Zyra e Burimeve Njerëzore mbledh dhe administron dokumentacionin sipas formateve të unifikuara të Dosjes personale të stafit, i ka ato të ruajtura ndër vite. Këto të dhëna administrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale (Evidenca Nr.11 Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore, Evidenca Nr. 44.1; 44.2 Format Dosje Staf Akademik).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunimi me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka memorandum dhe marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione, ndërmmarrje dhe organizata (Evidenca Nr.34.1-34.18 Marrëveshjet e bashkëpunimit). Gjithashtu institucioni ka një zyrë të titulluar “Zyra e Karrierës” që realizon udhëzimin drejtë karrierës me institucione publike dhe kompani private, studio ligjore si dhe përzgjedh ekspertët e fushës të cilët referojnë në auditor në seancat e programuara për programin e studimit.</p> <p>Për studentët të cilët kryejnë një punim diplome, për të përmbyllur detyrimet e tyre (ata që plotësojnë kriterin e mesatares), departamenti vë në dispozicion të studentëve, stafin akademik të kualifikuar, për t’i udhëhequr gjatë realizimit të saj (Evidenca Nr. 32.1 Dokumenti B.1, Mbi praktikën profesionale, pika B.1.3.1 Evidenca Nr. 10 Dokumenti B II, Mbi punimin e diplomës dhe disercionit).</p>
<p>Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të</p>	<p>Ky program studimi e ka të përfshirë në kurrikul praktikën profesionale (Evidenca Nr. 7 Rregullore MSH Shkenca Politike”). Mbështetur mbi marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe organizata të ndryshme, UET mundëson kushtet e nevojshme për</p>

ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	zhvillimin e veprimtarive praktike profesionale të studentëve. (Evidenca Nr.32 Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale; Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e bashkëpunimit; Evidenca Nr.32.1 Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale).			
Konkluzione	<p>Referuar vitit akademik 2022-2023, IAL ka angazhuar në këtë program studimi 11 personel akademik efektiv dhe 4 me kontratë. Në këtë vit akademik në programin e studimit janë përfshirë dy anëtarë me Msc., në proces doktorature. Theksojmë se në zbatim të akteve ligjore në fuqi (specifikisht neni 59 pika 6 e Ligjit Nr. 80/2015 dhe në respektim të standardeve më të larta të mësimdhënies, institucioni në vijim të angazhojë personel akademik me të paktën gradën Doktor Shkencash.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të programit, evidentohet se jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë "Profesor", sikurse kërkohet nga neni 59, pika 3 e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, ndaj GVJ rekomandon që IAL të caktojë si titullarë lëndësh, personel akademik të kësaj kategorie.</p> <p>GVJ konfirmon se, për këtë program studimi, personeli akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies, me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbush kërkesat ligjore në fuqi lidhur me ngarkesën mësimore.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore ka të përcaktuara qartë rregullat dhe procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik dhe mbështetës të angazhuar në këtë programi studimi. Institucioni ka memorandume dhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione, ndërmarrje dhe organizata të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit	Vizita e GVJ u krye në mjediset UET, e cila ndodhet në adresën: Rruga "Xhanfize Keko" Nd, 56 në Tiranë. Institucioni ka një sipërfaqe prej 8423.84 m ² , ku aktualisht janë në përdorim 14 salla leksionesh, 18 salla seminaresh, 23 salla laboratorësh. UET garanton mundësi të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore pasi institucioni ka kushte infrastrukturore bashkëkohore, në aspektin teknik dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.ascal.al


E-mail: info@ascal.al




dhe moduleve përkatëse.	didaktik, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh. Mjediset janë shumë të mira dhe të përshtatshme për klasa leksioni/seminari, zyra për stafin, biblioteka në funksion të zhvillimit sipas parametrave bashkëkohore të programit të studimit. Kampusi ka ëi-fi dhe akses në internet. Të gjitha këto mjedise u panë nga GVJ gjatë vizitës në institucion (<i>Evidenca Nr.42 UET Infrastruktura në funksion të Programeve të Studimit Blv. Gjergj Fishta; Evidenca Nr.42.1 UET Infrastruktura në funksion të Programeve të Studimit Rruga "Xhanfize Keko"</i>).
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore infrastrukturore të UET janë të pajisura me teknologjinë e fundit dhe garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, në përputhje me programin e studimit. Të gjitha mjediset mësimore janë të pajisura me pajisje teknologjike që lehtësojnë procesin e mësimdhënies-mësimnxënies në auditoret e UET. UET ka investuar në sisteme të cilat e mbështesin personelin akademik dhe studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin MOODLE (UET LMS) (<i>Evidenca Nr. 46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS; Evidenca Nr. 46.6 Raportimet javore të mësimin online</i>), i cili bën të mundur që studenti në kohë reale të azhohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audiovizive etj. I gjithë kampusi është i mbështetur edhe me rrjet ëi-fi dhe pajisjet e nevojshme elektronike si PC, laptop, printera, etj në zyrat e stafit akademik dhe atij administrativ (<i>Vizita në institucion; Evidenca RVB MSH Shkenca Politike.</i>).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Kushtet e ambjentëve në UET janë mëse të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit mësimor të ciklit të dytë të studimeve Master i Shkencave në “Shkenca Politike” me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh për aftësimin teorik e praktik të studentëve dhe arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Mësimi zhvillohet në salla leksioni të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet duke ju mundësuar studentëve paraqitjen e materialeve të ndryshme dhe dokumentacioneve të cilat do të hasin gjatë praktikës së punës, u demonstron si bëhen teste të ndryshme, etj (<i>Vizita në institucion</i>).
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në mjediset e UET, GVJ konfirmon pajisjen e mjedisëve me teknologjinë e nevojshme për sigurimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies maksimale. UET ka aktualisht në përdorim 23 laboratorë nga të cilat, 11 laboratorë mësimorë, 7 laboratorë informatike, 1 sallë internet dhe 4 laboratorë të arteve të cilët janë në dispozicion për programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë dhe mjaftueshëm salla mësimore për zhvillimin e procesit akademik (32 salla leksioni dhe seminari) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Kapacitetet e UET dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera ((Evidenca Nr.32 Lista e subjekteve bashkëpunuese për praktikën profesionale; Evidenca Nr.34 Marrëveshjet e bashkëpunimit; Evidenca Nr.32.1 Dokumenti B.1 Mbi praktikën profesionale). mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktivitetet e tjera. Mjediset mësimore si klasa, auditorë e laboratorë mundësojnë realizimin e procesit mësimor. Nga vëzhgimi i drejtëpërdrejtë i auditorëve, laboratorëve, programeve të reja kompjuterike, bibliotekës gjatë vizitës u konstatua se mjediset mësimore dhe ato ndihmëse janë të pajisura me lidhje interneti dhe me pajisje elektronike të teknologjisë së informacionit duke siguruar përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies - mësimnxënies (Vizita në institucion).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur si dhe takimet dhe vizitat në UET, GVJ konkludon se institucioni vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimor të këtij programi studimi.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET e cila është e përbërë me sallë bibliotekë, sallë leximi dhe me një ambient ku ndodhet fondi i librave është e pajisur me literaturë fizike dhe atë digjitale (Evidencë Nr. 42.1 Infrastruktura në funksion të programeve të studimit). Biblioteka është abonuar për një periudhë 5-vjeçare në libraritë elektronike Sage & Ebsco si edhe Questia dhe është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). GVJ vizitoi Bibliotekën, shqyrtoi literaturat e detyrueshme në syllabuset e lëndëve të programit dhe pas diskutimeve me stafin akademik dhe studentët konkludon se studentët kanë literaturën bazë dhe ndihmëse në dispozicion. (Evidenca Nr. 45. Inventari i teksteve shkencë politike; Vizita në institucion).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse ruan vit pas viti listën e evidentave të literaturës bazë, sipas formatit të përcaktuar (Evidenca Nr. 37.1 A-III-5-6 Formatit i mbulimit të lëndëve me literaturë) ndërsa përgjegjësi i grupit mësimor i cili shqyrton silabuset e dorëzuara nga stafi akademik, raporton mbi të gjitha elementët përfshirë literaturën (Evidenca Nr.37 Formatit Raporti</p>



	<p><i>i Vlerësimit të Programeve të Lëndëve).</i></p> <p>Gjithashtu, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm i cilësisë mbi përputhshmërinë e hartimit të silabuseve me standardet e UET kryen kontrollin dhe raportimin e përditësimeve në literaturë (<i>Evidencë NR.30.10 Format_Matrica e përputhshmërisë së silabuseve; Evidencë NR. 30.11 Shembull_Komunikimet dhe shpërndarja e relacionit të KSBC mbi silabuset; Evidencë Nr. 30.12 Shembull_Relacioni i KSBC mbi silabuset DSHSA_FSHJPMN).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës e cila ndahej në dy ambiente kryesore: një pjesë i është rezervuar hapësirës së studimit me (41 vende leximi) dhe koleksionit të titujve dhe një hapësirë tjetër është e pajisur me PC për të mundësuar aksesin e literaturës digjitale nga studentët, stafi akademik apo ai administrativ.</p> <p>Biblioteka e UET është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, libra apo revista shkencore në gjuhën shqipe dhe të huaja, në përputhje me natyrën e programve të studimit. Biblioteka ka krijuar një katalog me libra elektronik në gjuhë të huaja, i cili ka qindra tituj librash në bazë të programeve të studimit dhe që u vjen në ndihmë studentëve të të gjitha niveleve të studimit. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga e Hëna-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00- 17:00. (<i>Evidenca RVB</i>)</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET është e pajisur me literaturë fizike si tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, CD dhe harta, libra apo revista shkencore, në gjuhën shqipe dhe të huaja, në përputhje me natyrën e programit të studimit. Aksesin e literaturës së programit nga studentët, garantohej nëpërmjet literaturës fizike në bibliotekë dhe aksesit në libraritë elektronike Sage, Ebsco dhe Questia. Lektorët mund t'juaj vënë materialet në dispozicion në sistemin UET LMS (<i>Evidencë Tabela Nr. 17: Të dhëna për platformat on-line/strukturat IT/Biblioteka</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UET i krijon kushte studentëve, stafit akademik dhe administrativ, për të aksesuar pa pagesë bibliotekat online si bibliotekat dixhitale Sage, Ebsco dhe Questia, etj ku mbulohen të gjitha fushat e studimit, përfshirë edhe shkencat politike e shoqërore (<i>Evidenca RVB; Vizita në institucion</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka ofron akses në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë në bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga institucioni. Biblioteka e UET është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online) dhe ka akses në katër platforma elektronike: SAGE, EBSCO, Edëard Elgar Publishing, ASTM Compass.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në</p>	<p>Biblioteka është e hapur çdo ditë të javës. Gjatë javës ajo funksionon nga ora 9.00 deri në orën 20.00 dhe ditën e Shtunë 9:00-17:00. Orari i</p>


<p>orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>shërbimit është në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave të studentëve dhe stafit, për shembull gjatë sezonit të provimeve biblioteka është e hapur me orar të zgjatur. (Evidenca Nr. 45.1. Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës)</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>UET vit pas viti realizon pasurimin e fondit të bibliotekës me literaturë dhe përmes abonimeve në bibliotekat digjitale krijon infrastrukturën për rritjen e aksesimit në këto biblioteka. Procedurat e pasurimit të bibliotekës, janë të përcaktuara edhe në dokumentat që rregullojnë veprimtarinë e Institucionit. (Evidenca 45.3) Gjatë vizitës në institucion, në vizitën në bibliotekë u njohëm me kartela të studentëve dhe personelit akademik, të cilat e dëshmonin shkakllën e mjaftueshme të shfrytëzimit. (Evidenca RVB; Vizita në institucion)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në pjesën më të madhe të tij, programi i studimit përmban literaturën e nevojshme në mbështetje të mësimdhënies që ju mundëson stafëve akademike t'i referojnë në syllabuset dhe studentëve t'i përdorin ato. Në tërësi, biblioteka e UET është e pajisur me literaturë fizike në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze në përputhje me natyrën e programit të studimit, të cilat plotësohen nga aksesit në platformat digjitale që janë të aksesueshme pa pagesë si për stafet akademike dhe studentët. Mjediset mbështetëse të bibliotekës, kompjuterat, aksesit në internet kapërcejnë kufizimet e fondit fizik të burimeve të informacionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri I. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në</p>	<p>Institucioni disponon sistem të menaxhimit të informacionit me në qendër studentin i quajtur UMIS (Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit) i cili mbështet studentin në procesin mësimor dhe shërben për komunikimin e brendshëm. Ky sistem përfshin komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>programin e studimit.</p>	<p>studentëve dhe ju mundëson informim në kohë reale lidhur me aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim. Një nga funksionet kryesore të UMIS është: Sistemi i Menaxhimit të Studentit, i cili përmban informacionin personal të studentit, regjistrimin e notave, adresat e tyre, së bashku me rezultatet e provimeve ndër vite. Administrimi i informacionit në këtë platformë realizohet në mënyrë korrekte, duke i shërbyer stafit akademik dhe studentëve për të parë ecurinë e punës së tyre. (Evidenca Nr.46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS, Evidenca Nr.46.2 UET LMS Guide per pedagogun, Evidenca Nr.46.3 UET LMS Guide per studentet).</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Njësia përgjegjëse për administrimin e dokumentacionit dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ është Zyra e Burimeve Njerëzore (Evidenca Nr.11 Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore). Kjo zyrë disponon në dy versione atë në hardcopy dhe të skanuar dosjen e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ. Zyra e Burimeve Njerëzore realizon përditësimin e dosjeve të stafit bazuar në kërkesat dhe ndryshimet ligjore të Republikës së Shqipërisë.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit sigurohet akses i dedikuar nëpërmjet logimit me kredencialet personale në platformën UET LMS (Learning Management System), duke filluar nga viti akademik 2016 - 2017. Sistemi UET LMS përfshin informacionin bazë si regjistrimin e studentët në lëndët e tyre përkatëse, akses në literaturën e lëndëve që ndjekin etj. Sistemi mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Nëpërmjet UET LMS, bëhen edhe lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti (Evidenca Nr.46 .2 UET LMS Guide per pedagogun; Evidenca Nr.46.3 UET LMS Guide per studentet).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Përmes sistemit të menaxhimit UET LMS realizohet akses i dedikuar në bazë të programeve të studimit për stafin dhe studentët. Ky sistem menaxhimi lehtëson komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet, detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ofruar ndërveprim ndërmjet stafit dhe studentëve (Evidenca Nr.46 Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platforma LMS bënë të mundur komunikimin online për menaxhimin e të dhënave të studentëve dhe i mundëson akses studentëve dhe stafit akademik si dhe disa departamenteve të institucionit informim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ për studentin nga regjistrimi deri në diplomim. Sistemi mundëson raportime statistikore për çdo pedagog në lidhje me përdorimin e LMS-së. (Evidenca RVB)</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme.</p>	<p>GVJ kontrollon informacionin e disponueshëm në faqen online të UET www.uet.edu.al e cila është në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Faqja është e pasur me informacionin të nevojshëm për studentët, personelin</p>




publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë. ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	akademik dhe të gjithë personat e interesuar mbi programet e studimit dhe aktivitetet e ndryshme. Përdorimi i rrjeteve sociale si Facebook, Instagram, shërbejnë gjithashtu, si një mjet komunikimi për të publikuar aktivitetet që zhvillohen në UET. (<i>Evidenca Nr. 48 Dokumenti E.V. Mbi politikat e prezantimit/promovimit të UET on – line</i>)			
Konkluzione	<i>UET disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion në kohë reale të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Faqja online e UET është në dy gjuhë shqip dhe anglisht, si dhe e pasur me informacionin e kërkuar nga studentët, personeli akademik dhe publikun e interesuar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në RVB dhe dokumentet e titulluara “Pasqyrat financiare me shënime” dhe “Raportet e auditimit” konstaton se raporti financiar hartohet në nivel institucioni çdo vit (<i>Evidenca Nr. 50.1-50.3 Pasqyrat financiare me shënime</i>). Raporti financiar vjetor, i cili hartohet në bazë institucioni dhe jo të ndarë sipas programeve specifike, përmbajnë të dhëna të hollësishme që lidhen me pozicionin financiar, performancën apo fluksin e mjeteve monetare për llogaritjen e kostove të programit dhe plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. (<i>Evidenca RVB</i>)

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Burimet financiare të UET janë:</p> <p>a) Tarifa për dhe gjatë shkollimit që paguajnë studentët;</p> <p>b) Financimet nga Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj;</p> <p>c) Të ardhurat nga Aktivitetet tregtare (qeradhenie, provime, vertetime) <i>(Evidenca Nr.0.2 Tabela Permbledhëse për Aneks_RVB MSH_SHP Tabela 18.2 Të ardhura dhe financime të ndryshme).</i></p> <p>Plani i financimit hartohet në nivel institucional, ku përfshihen të gjithë kostot dhe të ardhurat por nuk hartohen raporte në bazë të programeve të studimit. Miratimi i buxhetit realizohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit të UET.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni kryen auditim vjetor periodik përmes auditimit të jashtëm nga shoqëri që ofrojnë këtë shërbim. Në vitin 2021 ky proces është realizuar nga Shoqëria audituese “E.E.I. shpk” <i>(Evidenca Nr.50.4-50.7 Raportet e Auditimit).</i> Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit <i>(Evidenca Nr.50.1-50.3 Pasqyrat financiare me shënime).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në nivel institucioni realizohet raport financiar përmbledhës i cili është i përvitshme. Financimi dhe menaxhimi sa më i mirë i burimeve financiare siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Per secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e qendrueshme dhe rezultative të institucionit. <i>(Evidenca Nr.0.2 Tabela Permbledhëse për Aneks_RVB MSH_SHP Tabela 18.1 Të dhena mbi koston per student).</i> Bazuar në RVB raportet periodike realizohen në transparence dhe bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë përpara i takon kontabilizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Burimet e financimit që institucioni disponon bëjnë të mundur qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile si dhe garanton kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. <i>(Evidenca Nr. 0. RVB MSH Shkenca Politike)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për</i></p>




	<i>realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit përmes tarifave studentore, financimet nga donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione të ndryshme, të ardhurat nga aktivitetet tregtare etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve UET i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi siç janë Ligji i Arsimit të Lartë udhëzimi “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës”, por edhe dhe rregulloreve të brendshme të hartuara nga institucioni (<i>Evidenca Nr. 27.1, Dokumenti “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve”</i>).</p> <p>Informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online në broshurën informuese, si edhe i ofrohet studentëve gjatë procesit të këshillimit në insitucion (https://uet.edu.al/en/si-te-aplikojme/). Pas regjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matkulimi nga QSHA dhe me kartën e studentit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, ndërkohë që ecuria e tyre ndiqet gjatë të gjithë procesit mësimor deri kur përfundojnë studimet (<i>Evidenca Nr. 27.1, Dokumenti “Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve”</i>).</p>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Në nenin 42 të rregullores së institucionit përcaktohen në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga regjistrimi, deri tek përfundimi i studimeve apo transferimet në programe të tjera studimi duke ofruar një proces transparent dhe barazi në trajtimin e studentëve ndërsa sanksionohet barazia ndërmjet studentëve pavarësisht racës, fesës,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




	<p>originjës etnike, orientimit seksual, statusit personal apo paftësive fizike, si edhe mbështet diversitetin (<i>Evidenca Nr. 5, Rregullore UET</i>).</p> <p>Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara (<i>Vizita në institucion</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton në regjistrimin e studentëve në varësi të kapaciteteve infrastrukturore dhe akademike të propozuara nga Departamenti dhe të miratuara nga Senati Akademik që përcakton numrin maksimal të studentëve për secilin program studimi, si edhe në respekt të legjislacionit në fuqi siç janë: Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave (<i>Evidenca Nr. 27.1, Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni realizon një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi siç është Gjimnaz Tour duke informuar të interesuarit mbi procedurat e pranimit dhe regjistrimit në UET, ndërsa për të gjithë studentët e rinj realizohet Java e Orientimit (<i>Evidenca Nr. 51, Politikat e Marketingut të Programit të Studimit</i>). Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimit në universitet në përputhje me nenin 76 të ligjit nr. 80/2015. Në rastin e studentëve me diplomë të huaj është i nevojshëm ekuivalentimi i diplomës sipas dispozitave në fuqi apo edhe i krediteve në rast se transferohen nga një institucion tjetër i arsimit të lartë (<i>Evidenca Nr. 28, Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>UET informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes online (https://uet.edu.al/) ku ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve dhe stafit të UET, lidhur me karakteristikat e programeve të studimit, numrin maksimal të studentëve, kurrikulat, dhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni (<i>Evidenca Nr. 27.1, Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"</i>).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UET i publikon kuotat në faqen online dhe pranon kandidatët në varësi të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore të tij dhe sipas kriterëve specifike që propozohen nga departamenti dhe miratohen nga Senati Akademik (<i>Evidenca Nr. 27.1, Dokumenti "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"</i>).</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin e studentëve në çdo program studimi, UET i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi sic janë Ligji i Arsimit të Lartë, udhëzimi "Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës", por</p>




	edhe rregulloreve të brendshme të hartuara nga institucioni (<i>Evidenca Nr. 27.1, "Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve"</i>).			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	IAL ofron mbështetje financiare pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë zyrës përkatëse në respekt të legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të institucionit për shtresat në nevojë, për të stimuluar numrin e studentëve në disa programe studimi, si edhe në fushat strategjike për zhvillimin e vendit (<i>Evidenca Nr.25, Tabelat për bursat e studentëve 2018-2023</i>).			
Konkluzione	<i>UET ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike, përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. UET ka një legjislacionin të qartë institucional për transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Studenti njihet me rregulloren e programit dhe aktet e tjera normative, të cilat përcaktojnë kriterit e kalimit nga një vit akademik në tjetrin në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore mësimore e MSH Shkenca Politike</i>). Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit dhe vihet në dispozicion të studentëve nëpërmjet sistemit UMS dhe LMS, sistem në të cilin ka akses edhe stafi akademik me kohë të plotë për tu njohur me rezultatet e studentëve, për të verifikuar ecurinë e studentëve, dhe për të bërë këshillimet e nvojshe mbi progresin akademik (<i>Evidenca Nr. 46, Manual i përdoruesit të sistemit UMIS</i>).
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nëpërmjet dokumentave rregullatore, studentët marrin informacion mbi procedurat e njohjes së diplomës, kualifikimeve të mëparshme, si edhe udhëzime mbi procedurat e transferimit duke shpjeguar kriteret - siç u sqarua më lart - për njohjen e krediteve dhe duke informuar më pas studentin nëpërmjet Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit (ZKS) për kreditet e njohura (<i>Evidenca Nr. 28, Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin</i>).
Kriteri 3. Institucioni informon	IAL operon me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si

<p>studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>njësi matëse e ngarkesës akademike. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si edhe kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Rregulloren e Programit dhe specifikohen në një seksion të veçantë të sillabusit të programit (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore mësimore e MSH Shkenca Politike</i>).</p> <p>Zakonisht dijet e përfituara në një lëndë vlerësohen duke u bazuar në provimin përfundimtar, pjesëmarrjen aktive të studentit në klasë si edhe komponentë të tjerë si detyra kursi, raste studimore, apo punë në terren dhe këto informacione vihen në dispozicion të studentëve si në javën e parë të programit (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore mësimore e MSH Shkenca Politike</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentët finalizojnë procesin e studimit nëpërmjet punimit të temës së diplomës apo një provimi përfundimtar (<i>Evidenca Nr. 5. Rregullore e UET, neni 39, pika 1</i>). Një rregullore e veçantë është miratuar për provimin përfundimtar apo punimin e diplomës, e cila përcakton të gjitha parakushtet dhe procedurat që duhet të përmbushin studentët për projektin e diplomimit, ndërsa nformimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura është detyrë e departamentit (<i>Evidenca Nr. 10. Mbi punimin e diplomes dhe disertacionit</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo pranverë universiteti organizon dhe zhvillon takime me maturantët si “Open Days” dhe “Gjimnaz Tours” për tu ofruar atyre informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit në UET, si edhe merr pjesë edhe në panaire të organizuara ku ofron udhezime dhe informacione për kandidatët e mundshëm (<i>Evidenca Nr. 10.1, Kalendari Akademik</i>).</p> <p>UET organizon gjithashtu dhe Javën e Orientimit për studentët e rinj, ku grupe pedagogësh dhe stafi ndihmës i universitetit u ofrojnë studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për secilin program lidhur me rregulloren, mundësinë e transferimit të kreditive të studimit, etj. (<i>Evidenca Nr. 27.1 Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET ofron mjete të ndryshme për njohjen e programit nga ana e studentëve dhe këto përfshijnë si transparencën online me informacion të hollësishëm për programin e studimit, javën hyrëse ku pedagogët pjesëmarrës japin informacionin e nevojshëm, apo edhe Zyrën për Kujdesin ndaj Studentit që shërbejnë si pikë reference për të dhënë një informacion të plotë e të hollësishëm mbi njohjen e programit të studimit, përparimin akademik, njohjen e krediteve, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin në fjalë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X




Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit informon studentët mbi strukturën e programeve duke harmonizuar takimet në zyrë me informacionin në faqen zyrtare https://uet.edu.al/master-shkencor/ ku studentët gjejnë falë rregulloreve përkatëse të programeve dhe kontratës së nënshkruar në fillim të studimeve, të gjithë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit, sic jane kohëzgjatja e programit, tarifat e studimit, përbërja e lëndëve etj (<i>RVJ fq.65, Takim me Studentët</i>). Studentëve ky informacion mund ti ofrohet edhe i printuar, por edhe u krijohet mundësia për tu takuar me pedagogët dhe për të marrë më shumë informacion mbi programin.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përveç informacionit të ofruar në faqen e internetit dhe nga strukturat përkatëse në momentin e regjistrimit, studentit i ofrohet i gjithë informacioni i nevojshëm si p.sh. syllabuset që në javën e parë të studimeve, për ti informuar studentët mbi planin mësimor, modulet, përmbajtjen e lëndëve, nivelin e detyrueshëm të frekuentimit, format e kontrollit të njohurive, literatura bazë dhe e rekomanduar. Studentët informohen gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomës (<i>Evidenca Nr. 7. Rregullore mësimore e MSH Shkenca Politike</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Zyrat Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, në bashkëpunim me këshilluesin e karrierës së çdo fakulteti/departamenti informojnë studentët në lidhje me nevojat e tregut të punës edhe falë seancave keshillimore për studentët që ata të njihen me mundësitë e punësimit apo praktikave që mund të ndjekin pranë institucioneve të ndryshme (<i>Evidenca Nr. 12. Mbi funksionimin e zyrës së Karrierës dhe Këshillimit të Studentit</i>). Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Karrierës është organizimi i panairëve të punës dhe takimeve së bashku me përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, dhe Alumni të diplomuar në UET (<i>Evidenca Nr.12.1, Bordi i Tregut të Punës</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për studentët si nëpërmjet mjeteve të përdorura më lart, ashtu edhe falë kontakteve të rregullta me Koordinatorin e Departamentit për tu informuar por edhe përditësuar me ndryshimet (<i>Evidenca Nr. 9, Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore, pika E.1.6.3</i>).</p> <p>Këto informacione ofrohen edhe në këndin e njoftimeve, ndërsa për informacionet e të gjitha strukturave të UET në shërbim të studentit</p>





	dërgohen studentëve nëpërmjet sistemit LMS (<i>Takim me përfaqesuesit e Zyrës për Kujdesin ndaj Studentit</i>).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Pasi studentët rregjistrohen në UET, zyra e IT u siguron një email, emër përdorimi dhe kod për të patur akses në listën e tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Falë sistemit online, ky akses si edhe kontakti me pedagogët (nëpërmjet sistemit chat) i mundësohet studentëve në cdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet. (<i>Evidenca Nr. 46, Manuali i perdoruesit te sistemit UMIS</i>)			
Konkluzione	<i>Programet e studimit dhe syllabuset përkatëse janë në dispozicion të studentëve duke përfshirë si format e vlerësimit, objektivat mësimore që pritet të arrihen në përfundim të kursit, si edhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së këtyre objektivave formuese.</i> <i>Struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me këshilltarin akademik dhe stafin ndihmës të programit. Përtej programit të studimit, organizohen me ndihmën e stakeholders-ave edhe panairë për tu dhënë mundësinë studentëve të njohin tregun e punës por edhe pedagogëve për të kuptuar nevojat reale të tregut, në mënyrë që kurrikula të përshtatet sa më mirë me këto nevoja për të rritur kështu mundësitë e punësimit të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Statistikat mbi numrin e studentëve, shpërndarjen e tyre sipas programeve, notat e marra, studentët e diplomuar apo edhe të punësuar përditësohen çdo vit nga UET (<i>Evidenca Nr. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje MSH Shkenca Politike</i>). Këto të dhëna dokumentohen në “Dokumentin e Performancës”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL (<i>Takime me Sekretarinë Mësimore</i>). Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit, emrat e kompanive apo insitucioneve ku janë punësuar të detajuara për secilin program studimi (<i>Evidenca Nr. 9, Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore</i>).
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e	Sistemi i menaxhimit të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen



<p>studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>e të dhënave personale të studentëve për secilin program studimi si ecurinë akademike, regjistrimet, transferimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, etj. falë sistemit UMIS (<i>Evidenca Nr. 27. Cilësia në hyrje dhe dalje MSH Shkenca Politike</i>). Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale e studentëve që janë në programeve të studimit, atyre që janë shkëputur përkohësisht apo përgjithmonë. Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni (<i>Takime me Sekretarinë Mësimore</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Secili student ka dosjen e tij në Sekretarinë mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve, ku përfshihen të dhënat personale të studentëve, të cilat menaxhohen përmes platformës së brendshme të UET. Sekretaria mësimore e përdor këtë platformë jo vetëm për të hedhur të dhëna por edhe për të vënë në dispozicion të dhënat që nevojiten për analizat, raportet apo hartimin e strategjive të institucionit (<i>Takim me Sekretarinë Mësimore</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, IAL ka ngritur sistemin e menaxhimit UMIS i cili ka si objektiv jo vetëm ruajtjen dhe administrimin e të gjitha të dhënave të studentëve sic u theksua më lart, por edhe kontrollin e procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative (<i>Evidenca Nr. 50.5, Raporti Auditimit 2020</i>).</p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në bazë të të dhënave të vëna në dispozicion nga Sekretaria Mësimore përsa i takon numrit të studentëve të regjistruar, diplomuar, apo shkëputur nga programet e studimit dhe të dhënave të ofruara nga Zyra e Karrierës përsa i takon një pasqyrë të studentëve të diplomuar, punësimit të tyre dhe profilet e punësimit, Departamentit përkatës disponon të dhënat e nevojshme për hartimin e raporteve dhe analizave duke evidentuar nevojat për përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me kërkesat e tregut të punës (<i>Evidenca Nr.38, Analiza e Departamentit për Programin</i>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Strukturat e UET bëjnë një punë të vazhdueshme për të mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhëna të hollësishme lidhur me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, shoqëruar me të dhëna për punësimin e tyre.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në nenet 16, të Statutit, UET saknksionohet pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjet institucionale, organizimin e lirë dhe shprehjen e mendimit të tyre (<i>Evidenca Nr. 2 Statuti UET</i>). Për këtë qëllim funksionojnë struktura të veçanta siç janë Këshilli Studentor që koordinon përfaqësimin e studentëve në organet drejtuese, Senati Akademik ku merr pjesë një student, Këshilli i Etikës, ku një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve, KSBC ku një anëtar zgjidhet nga Këshilli i Studentëve, si edhe mbledhja e përmuajshme e departamentit e cila është e hapur për studentët (<i>Evidenca Nr. 2 Statuti UET, neni 19 dhe 51</i>).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët vlerësojnë pedagogët më të cilët kanë zhvilluar mësim përpara përfundimit të çdo semestri duke patur parasysh cilësinë e mësimdhënies, literaturën e vënë në dispozicion, ndihmën e ofruar studentëve etj (<i>Evidenca Nr. 2 Rregullore e UET, neni 22, pika 2</i>). Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit (<i>Takim me Grupin e Punës për Hartimin e RVB</i>)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to. në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përveç plotësimit të pyetësorit dhe pjesëmarrjes në fokus grupe për tema të caktuara, si anëtarë të Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve (<i>Evidenca Nr. 2 Rregullore e UET, neni 22, pika 6</i>). Studentët kontribuojnë gjithashtu edhe nëpërmjet opiniove të shprehura në takimet me pedagogët përkatës (<i>Takim me Studentët e Programit</i>).
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studenti ka të drejtën e ankimimit nëpërmjet një procedure të caktuar, e cila u vihet në dispozicion si në mënyrë elektronike ashtu edhe të printuar. Zyra e Kujdesit ndaj Studentit merr në shqyrtim ankimimet e studentëve por edhe mbledh të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me ankesën apo kërkesën e paraqitur nga studentit dhe e paraqet pranë pedagogëve apo dekanit në varësi të kërkesës, vendimet e të cilëve mund të ankimohen tek Zv. Rektori i Universitetit (<i>Evidenca Nr. 40.3, Formulari për Ankesat e Studentëve</i>).
Konkluzione	<i>UET i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet anketave të lëndës ashtu edhe procesit të ankimimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e studentëve me fokus-grupe tematike. Kjo realizohet falë përfshirjes dhe angazhimit të</i>

	<i>studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, që veprojnë në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve funksionojnë në bazë të rregulloreve dhe në përputhje me udhëzimet dhe vendimet e organeve përkatëse të institucionit dhe Ministrisë së Arsimit, ndërsa detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren e kësaj zyre (<i>Evidenca Nr. 53.1, Rregullorja e Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit</i>).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentëve informojnë studentët përmes emaileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes informacionit të vënë në dispozicion në faqen e internetit lidhur me karakteristikat e programeve të studimit https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2022/04/Kalendari-akademi.pdf . Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjesëtarët e stafit akademik përgjegjës për programin, ndërsa informacioni më i detajuar lidhur me planin mësimor, syllabuset e lëndëve, datat e provimeve etj. ofrohet nga këshilluesi akademik (<i>Takim me Studentët</i>).
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Karrierës fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës dhe këshillimin e strukturave akademike të universitetit lidhur me këto nevoja, dhe ndan këtë informacion si me Zyrën e Cilësisë ashtu edhe me departamentet përkatëse, në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të kërkuara në tregun e punës, ndërsa informon në mënyrë të vazhdueshme studentët në lidhje me kërkesat e tregut të punës (<i>Evidenca Nr. 12, Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>). Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillimin e nevojshëm lidhur me mundësitë e karrierës si nëpërmjet takimeve individuale ashtu edhe nëpërmjet informacionit të përfshirë në analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit në bashkëpunim edhe me pedagogun i cili ka rolin e këshilluesit të karrierës pranë çdo

	departamenti (<i>Evidenca Nr. 12, Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit</i>).			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në databazën e Zyrës së Këshillimit të Karrierës përfshihen të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha nivelet akademike, si edhe identifikohet niveli i punësimit për këta studentë duke e integruar në Dokumentin e Performancës që përgatitet në përfundim të çdo viti akademik (<i>Evidenca Nr. 33, Të dhëna për punësimin e studentëve</i>). Ky informacion ndahet me drejtuesit e programeve, dekanët dhe rektoratin për të parë se çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen. Kontaktet me industrinë dhe insitucionet mbahen nga kjo Zyrë falë edhe kontakteve që ata kanë marrë në mënyrë të vazhdueshme me Alumni (<i>Evidenca Nr. 17, Studimi Periodik i Tregut të Punës</i>).			
Konkluzione	<i>UET ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve siç janë keshilltari akademik apo edhe pedagogët e lëndës të cilët së bashku me Zyrat Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. Një procedurë e veçantë siguron menaxhimin e ankimeve e problematikave, nga zyrat përkatëse të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri I. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë	Për aplikimin e strategjive, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies UET ka hartuar dokumenta dhe ofron për stafin akademik, sidomos për pedagogët e rinj, trajnimet se si duhen organizuar syllabuset, metodat e mësimdhënies, mënyrat e vlerësimit, frekuentimit apo përdorimit të platformës LMS. Ky trajnim fokusohet tek mobiliteti i

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




<p>të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>stafit, jo vetëm për të rritur kapacitetet profesionale të tij, por edhe për të krijuar më shumë mundësi për ndërkombëtarizim (<i>Evidenca Nr. 33, Të dhëna për trainimet profesionale të stafit dhe studentëve</i>).</p> <p>Punë e veçantë bëhet nga departamentet me pedagogët e rinj përsa i takon mënyrës së përgatitjes së programeve, kurrikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse, aspektet didaktike të mësimdhënies duke shpërndarë edhe përvojat më inovative të mësimdhënies në bazë të programet e studimit duke përdorur edhe programet dhe platformat online të IAL (<i>Evidenca Nr. 46.2, UET LMS online për pedagogun</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) dhe Zyra e Standardeve të Cilësisë, përbëjnë strukturat përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UET neni 11, pika 2</i>). KSBC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe atyre mbështetëse për studentët, për të garantuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UET neni 11, pika 3</i>). Ky komision është i përbërë nga 12 anëtarë që përfaqësojnë të gjithë departamentet dhe studentët, si edhe një ekspert i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve (<i>Evidenca Nr. 30.4, Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC</i>). Nën monitorimin e KSBC, ZSC harton anketat për studentët, të cilët kryhen dy herë në vit, si edhe fokus-grupe, ndjekjen e mësimdhënies në auditor, etj.</p> <p>Rezultatet e anketave i vihen në dispozicion të rektoratit dhe drejtuesit të departamentit, i cili i përfshin në raportin vjetor të departamentit, ku paraqiten vlerësimet për stafin akademik dhe ndihmës-akademik. Këtij vlerësimi i shtohet edhe ai i kolegëve për njëri-tjetrin dhe të gjitha këto vlerësime diskutohen në prani të përgjegjësit të departamentit (<i>Evidenca Nr. 30.3, Manuali i kontrollit të Brendshëm të Cilësisë</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UET nxit përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i veprimit të KSBC</i>). Këto pyetësorë, së bashku me pjesëmarrjen e studentëve në mbledhjet e departamentit, jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studentëve, ndërsa mënyra për të shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimit në lidhje me procesin e mësimdhënies por jo vetëm (<i>Evidenca Nr. 30.5, Metodologjia e Punës së KSBC</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në kuadër të transparencës institucionale, KSBC dhe ZSC pasi përpunon të dhënat e marra në mënyrat e përshkruara më sipër, harton dhe publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të UET https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/. Këto raporte i vihen në dispozicion personelit akademik dhe Drejtuesit të Departamentit për të marrë masat e nevojshme.</p>

<p>Kriteri 5. Institucioni. nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Për të nxitur zhvillimin profesional të stafit, UET, në çdo vit akademik, krijon mundësinë për trajnimet e stafit duke u bazuar edhe në rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet e raporteve të njësive të kontrollit të cilësisë duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor (<i>Evidenca Nr. 30.15, Shpërndarja e Ekstratit të Raporteve</i>). Përgjegjësi i departamentit ia percjell këto raporte dekanit, të cilët bashkarisht i kërkojnë pedagogëve të vlerësojnë se si janë plotësuar këto objektiva, ndërsa shqyrtohen më pas nga Rektorati duke u mbështetur edhe tek vlerësimet e performancës individuale për të vendosur për promovimin e pedagogut dhe mbështetjen për kërkimet shkencore, pjesëmarrjen në konferenca etj. (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimit të KSBC</i>). Këto vlerësime i shtohen atyre nga kolegët, studentët, takimet personale me stafin akademik, etj (<i>Takim me Stafin Akademik</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse siç janë KSBC apo edhe ZSC, metodologjitë dhe mjetet përkatëse për të zhvilluar këtë monitorim, si edhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Siç u shpjegua më lart UET kas strukturat e nevojshme të sigurimit të cilësisë por edhe procedurat e zhvilluara për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë (<i>Evidenca Nr. 1.1, Statuti i UET neni 11, pika 3</i>). Kjo sanksionohet edhe në Planin Strategjik të UET 2020-2025, ku rritja e cilësisë akademike, mësimdhënja por edhe përmirësimi i shërbimeve logjistike paraqiten si objektiva strategjike (<i>Evidenca Nr. 3, Plani strategjik i UET Strategic</i>). Për të mbështetur më tej zbatimin e këtyre procedurave KSBC ka hartuar rregulloren përkatëse dhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca Nr. 8, Mbi Sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e</p>	<p>Strukturat e sigurimit të cilësisë KSBC dhe ZSC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e institucionit dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me Manualin e Cilësisë. KSBC përbëhet nga 6 anëtarë të stafit akademik (përfaqësues të fakulteteve, një përfaqësues</p>

<p>vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>administrativ, një përfaqësues i studentëve, dhe një përfaqësues i jashtëm), ndërsa Zyra e Standardeve të Cilësisë ka si qëllim përpunimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave që synojnë rritjen e kontrollit të brendshëm të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 30.3, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë</i>).</p> <p>Strukturat e sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me fakultetet dhe departamentet organizojnë dhe finalizojnë formën e vlerësimit dhe performancën e pedagogut (<i>Takim me përfaqësues të KSBC</i>). Të dhënat përpunohen nga koordinatori i ZSC dhe përfshijnë të gjitha format e vlerësimit për pedagogun ndërsa të gjitha këto raporte përfshihen në raportin përfundimtar të departamenti (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimit të KSBC</i>).</p> <p>Këto struktura në bashkëpunim edhe me drejtuesit e njësive aplikojnë, koordinojnë dhe finalizojnë të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale (<i>Evidenca Nr. 30.3, Strategjia për sigurimin e cilësisë</i>).</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Manuali i Sigurimit të Cilësisë është dokumenti bazë për KSBC dhe ZSC për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies falë edhe nëpërmjet tërheqjes së mendimit të jashtëm për sigurimin e cilësisë që realizohet nëpërmjet proceseve të akreditimit (<i>Evidenca 54.3, Për Akreditimin Publik të Institucionit të Arsimit të Lartë UET</i>). Për të plotësuar sa më mirë rekomandimet e lëna gjatë akreditimeve, KSBC dhe ZSC hartojnë një plan që ndjek në vijimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve (<i>Evidenca Nr. F VII, Rekomandimet e Vlerësimit të Programit</i>).</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>KSBC si struktura e ngarkuar për sigurimin e cilësisë gjenerojnë analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart. Tërheqja e mendimit nga ana e KSBC prej pedagogëve, anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës, ASCAL apo partnerëve të tjerë ndihmon procesin e monitorimit por edhe të përmirësimit të cilësisë së programit (<i>Evidenca Nr. 30.2, Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>). Raportet e KSBC i dorëzohen Pergjigjësist të Departamentit, Dekanit dhe Rektoratit duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse të KSBC për përmirësimin e mëtejshëm të punës (<i>Takim me Përfaqësues të KSBC</i>).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UET harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke harmonizuar forma të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve, vetëvlerësimi i pedagogëve apo vlerësimi nga kolegët e tyre, rezultate të cilat harmonizohen në raportet përkatëse dhe zbatohen me udhëzimet e nevojshme nga strukturat e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë. që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Procesi i mbikëqyrjes së programeve të studimit bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti për tu plotësuar gjatë vitit akademik (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit MSH në Shkenca Politike</i>). Në përfundim të çdo viti akademik nga rektorati kërkohet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre objektivave, si edhe kryhet vlerësimi i stafit akademik në lidhje me realizimin e objektivave të marra, si edhe hartohet një plan veprimi për të mundësuar realizimin e tyre në të ardhmen (<i>Evidenca Nr. 30.2, Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>). Ky plan veprimi përdoret në vitet në vijim edhe bëhet pjesë e objektivave që duhet të përmbushin pedagogët apo departamentet (<i>Takim me Stafin Akademik të Programit</i>).</p> <p>Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces sa me gjithëpërfshirës për të promovuar praktikën pozitive (<i>Evidenca Nr. 7, Rregullore e Programit MSH në Shkenca Politike</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Përfshirja e sugjerimeve të studentëve me anketimet e përgatitura 2-3 herë në vit, kontributi i Këshillit Studentor, si edhe komunikimi i vazhdueshëm i studentëve me pedagogët krijon mundësinë e përfshirjes së pritshmërive në objektivat e të ardhmes (<i>Evidenca Nr. 40.1, Vetëvlerësimi i Pedagogut dhe Evdoenca 30.16 Vlerësimi i pedagogut nga eprori/kolegët</i>).</p> <p>Kjo praktikë bashkërendohet me vlerësimet e pedagogëve siç u përmend më lart dhe duke promovuar pedagogët të cilët arrijnë rezultate të larta si edhe duke ofruar çmimin (<i>Takim me Stafin Akademik të Programit</i>).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime</p>	<p>UET përdor një sërë mekanizmash për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si p.sh. vlerësimet e studentëve falë anketave, apo vlerësimet e kolegëve që synojnë evidentimin e aspekteve për tu përmirësuar dhe pikave të forta (<i>Evidenca Nr. 30.2, Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë</i>).</p> <p>Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të sillabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj. të cilat bëhen transparente për</p>




lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në teste me ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	të zbatuar një proces sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës (https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/). Integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikat mbështetëse për studentët krijon mundësinë e pasjes së disa strukturave në dispozicion të këtij objekti siç janë për shembull Këshilltari Akdemik, Zyra e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyra e Karrierës dhe Alumnit, etj. (Evidenca Nr. 30.2, Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë).			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Të gjitha grupet e interesuara siç janë studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ, si edhe partnerët e jashtëm, përdorin të gjitha instrumentat e lartpërmendura për të bërë vlerësimin e performancës së programeve të studimit duke bërë të mundur dhënien e rekomandimeve të nevojshme për arritjen e dy objektivave strategjikë: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve; b) përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të programeve (Evidenca Nr. 8, Raporti mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë). Zyra e Karrierës dhe Këshillimit të Karrierës mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti (Evidenca Nr. 12, Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit). Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairin e Punës i cili organizohet në mënyrë periodike në muajin Maj nga UET (Evidenca Nr. 12.3, Panairi i tregut të Punës).			
Konkluzione	UET monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike përmes organeve përkatëse cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit dhe kapaciteteve profesionale të studentëve për të qenë sa më të përgatitur për nevojat e tregut të punës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e	Siç u theksua më lart, strukturat e ngritura dhe procedurat e zbatuara janë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Për Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. Përveç kornizes ligjore, bashkëpunimi edhe me organizma të tilla si Bordet e Tregut të Punës apo pjesëmarrja në

<p>vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>projekte ndërkombëtare si Enchase dhe Erasmus+ i mundësojnë KSBC të sigurojë edhe thithjen e mendimit nga aktorët e jashtëm dhe nga ekspertiza ndërkombëtare në sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca Nr. 4, 4. Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit - MSH Shkenca Politike</i>).</p> <p>KSBC si struktura përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështetet nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në respektimin e procedurave të sanksinuara në Manualin e Cilësisë (<i>Evidenca Nr. 30.2, Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, në nenin 103 dhe 104, në Nenin 11 të Statutit të UET, strukturat e IAL kanë hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 30.2, Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë</i>). Me këto struktura dhe procedura integrohet edhe plani i veprimit i hartuar për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Brodi i Akreditimit për çdo program studimi, në të cilën përcaktohen detyrat për çdo strukturë të UET.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Organet e sigurimit të cilësisë së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çështjet e cilësisë, duke monitoruar të gjitha proceset, aktivitetet dhe veprimtaritë si akademike edhe të shërbimeve, falë mekanizmeve të përmendura më lart (<i>Evidenca Nr. 30.3, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë</i>).</p> <p>Njësia bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe në bashkëpunim me organet përkatëse të sigurimit të cilësisë bën të mundur analizimin e të dhënave të marra – falë bashkëpunimit me zyrat administrative - dhe përgatitjen e hapave të caktuar për përmirësimin e problemeve të vërejtura dhe përgjithësimin e praktikave pozitive (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimit të KSBC</i>).</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>KSBC zgjidhet nga Senati Akademik me 9 anëtarë dhe përfaqësojnë të gjitha fakultetet, administratën, këshillin studentor dhe një përfaqësues të jashtëm. (<i>Evidenca Nr. 3, Stauti i UET</i>).</p> <p>Anëtarët e këtyre organeve përzgjidhen nga stafi akademik me eksperiencë dhe me integritet duke vlerësuar kompetencat e tyre profesionale për të shmangur çdo lloj pabarazie në trajtimin e studentëve apo pedagogëve (<i>Evidenca Nr. 3, Stauti i UET, neni 11</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që</p>	<p>Si partner në projektet Erasmus+ dhe Tempus, UET ka marrë mbështetje për forcimin e strukturave të sigurimit të cilësisë duke përfituar në drejtim të përmirësimit të praktikave, procedurave dhe ekspertizës në përmirësimin e monitorimit të cilësisë (<i>Evidenca Nr. 30.15, Fisha e</i></p>




kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	<i>Projektit Enchase dhe Evidenca 30.16, Fisha e Projektit Enchase QainAl).</i>			
	Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, UET angazhon edhe partnerët strategjikë të insitucionit apo Bordin e Tregut të Punës. Kjo bëhet për të kuptuar më mirë nevojat e tregut të punës dhe që sugjerimet e mbledhura të integrohen në kurrikulat mësimore (<i>Takim me Zyrën e Karrierës</i>).			
Konkluzione	<i>UET përfshin: a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik nëpërmjet P2P revieë; c) dhe studentët nëpërmjet anketave dhe mekanizmit të ankimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit. Në rastin e evidentimit të problemeve apo praktikave pozitive krijohet mundësia që nëpërmjet formave të njuhësura siç janë raportet apo edhe takimet tematike të informojë palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe të kërkojë përpilimin e masave nëpërmjet departamentit si edhe zbatimin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, dhe në planin e përvitshëm që hartohet duke u bazuar në konkluzionet e raporteve të cilësisë së hartuara, si edhe objektivat e strukturave akademike përkatëse (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimit të KSBC</i>). Ndërkohë që informacioni lidhur me këto akte ligjore publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen e internetit të institucionit. Po kështu publikohen edhe rregullorja e njësisë, KSBC, dhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë (https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	UET publikon në faqen zyrtare të universitetit të gjitha vlerësimet e programeve të studimit për akreditimin institucional dhe vendos në dispozicion të publikut të gjitha vlerësimet nga ASCAL. Vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike, ndërsa konkluzionet dhe komentet u bëhen me dije drejtuesve të departamenteve dhe pedagogëve përkatës duke ruajtur konfidencialitetin, si për shembull rasti i takimeve individuale (<i>Evidenca Nr. 30.14,</i>

	<i>Vlerësimi i Pedagogut nga Kolegu dhe Eprori).</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi duke patur parasysh vlerësimin e secilit pedagog. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, Rektorati i kërkon Përgjegjësve të Departamenteve dhe Dekanëve që të hartojnë projekt-buxhetet e tyre me zërat përkatës duke përfshirë nevojat akademike dhe aktivitetet e departamenteve që synojnë rritjen dhe përmirësimin e cilësisë akademike, trajnimet e nevojshme apo pjesëmarrjen në programe për rritjen e aftësive shkencore dhe profesionale të stafit (<i>Evidenca Nr. 33, Të dhëna për trainimet profesionale për stafin dhe studentët</i>).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të IAL me KSBC dhe ZSC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në sigurimin e cilësisë (<i>Evidenca Nr. 30.3, Strategjia për Sigurimin e Cilësisë</i>). KSBC dhe ZSC hartojnë një raport vjetor ku përfshihen veprimtaritë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë (https://uet.edu.al/raporte-vleresimi/).			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies UET zbaton aktivitete të ndryshme si për shembull vizitat e ekspertëve të huaj akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, kërkimin e mënyrave për të përmirësuar ambientet në dispozicion që ato të mund të jenë sa më pranë nevojave të studentit dhe lëndëve përkatëse (<i>Evidenca Nr. 30.1, Plani i Veprimit të KSBC</i>).			
Konkluzione	<i>Prioritetet e vendosura, politikat, proceset e zbatuara, kriteret e përdorura dhe veprimtaritë e zhvilluara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente për të bërë sa më efektive implementimin e tyre, duke synuar krijimin e një kulture institucionale për arritjen e cilësisë dhe përmirësimin e proceseve për monitorimin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Politike”, me profile “Administrim Publik”, “Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”

Pika të forta dhe afirmime:

1. Një numër i lartë pedagogësh që kontribuojnë në modulet e programit, janë të arsimuar apo specializuar jashtë vendit dhe ndërmarrin aktivitete për kërkim shkencor cilësor të botuar në revista të njohura në fushat kërkimore të programit.
2. IAL ka një sistem transparent për vlerësimin e pedagogëve si nga ana e studentëve në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në bazë të publikimeve për të matur nivelin e kërkimit shkencor. Për botime në revistat me impakt faktor 1, ofrohet një shpërblim financiar nga institucioni.
3. Institucioni ka një infrastrukturë institucionale të mirë-organizuar dhe mbështetje financiare për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve.
4. Një praktikë pozitive janë format periodike të trainimit si staff “Development Day” dhe Back to Work, të cilat synojnë trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik.

Pika të dobëta:

1. Institucioni ka angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi personel akademik me Msc., dhe jo me të paktën gradë shkencore “Doktor”, si dhe jo të gjithë titullarët e lëndëve janë të kategorisë “Profesor”, sikurse kërkohet nga neni 59, pika 3 dhe 6 e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 (Standardi IV.1, kriteri 1).

Rekomandime:

1. Institucioni, të angazhojë në mësimdhënie në këtë program studimi personel akademik i cili zotëron të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe të caktojë si titullarë lëndësh personel akademik që i përkasin kategorisë “Profesor”, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi (Standardi IV.1, kriteri 1).
2. Në kuadër të përditësimit dhe përmirësimit të programit të studimit, Institucioni sugjerohet të vijojë me pasurimin e mëtejshëm të fondit të librave për këtë program studimi, për të kontribuar në një vizion më gjithëpërfshirës të koncepteve të studiuara (Standardi II.3, kriteri 5).
3. Institucioni, sugjerohet që, në mbështetje të eksperiencave ndërkombëtare dhe për një aplikim sa më të mirë nga ana e studentëve në praktikë të njohurive të përfituara përgjatë studimeve, të konsiderojë në vijim mundësinë e realizimit të praktikës mësimore në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimeve (Standardi I.3, kriteri 3; Standardi II.1, kriteri 3).



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Science in "Political Sciences", with profiles "Public Administration", "Management and Project Evaluation", provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana"

Strengths and affirmations:

1. A considerable number of teachers contributing to preparing/implementing the academic program are specialized abroad and undertake qualitative research in scientific journals operating in pertinent areas for the program.
2. The institution has in place a transparent process of evaluating the lecturers both from the perspective of students regarding teaching and based on publications to assess the level of scientific research. For publications in journals with an impact factor of 1, a financial reward is offered by the institution.
3. The institution has a well-organized institutional infrastructure to offer financial support for students' mobility.
4. Periodical training of the academic staff such as "Development Day" dhe "Back to Work", contribute to the continues profesional development of the acadmic staff and the capacity building of young teachers.

Weaknesses:

1. The institution has engaged academic staff with Msc. in teaching, rather than at least with a "Doctor" degree and not all subject holders hold the "Professor" category as required by Article 59, point 3 and 6 of the Higher Education Law 80/2015 (Standard IV.1, criterion 1).

Recommendations:

1. The institution should engage academic staff with at least a "Doctor" scientific degree to teach in this study program and should appoint academic staff belonging to the "Professor" category as subject holders, in accordance with the current legal provisions (Standard IV.1, criterion 1).
2. As part of updating and improving the study program, the institution is suggested to continue enriching the book fund for this study program to contribute to a more comprehensive understanding of the concepts studied (Standard II.3, criterion 5).
3. The institution is suggested to consider the possibility of implementing teaching practice in the second semester of the second year of studies, based on international experiences and for better application by students in practice of the knowledge gained during their studies (Standard I.3, criterion 3; Standard II.1, criterion 3).



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X